

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽISTA A.D.

A large, vibrant green tree with dense foliage is positioned in the upper left quadrant of the page. The tree's trunk and branches are dark, contrasting with the bright green leaves. The background behind the tree is a solid green color that transitions into a white background on the right side of the page.

2010-11

RAPORT VJETOR

RAPORT VJETOR 2010-11

Përmbajtja

KAPITULLI 1	8
Informatat bazë për kompaninë	8
Fjala e kretarit të Bordit të Drejtorëve	9
Fjala e kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT	10
Harta e Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës	12
Profili i Kompanisë	13
Vizioni	13
Misioni	13
Qeverisja Korporative.....	14
KAPITULLI 2	15
Korniza Ligjore dhe Rregullative	15
Parimet themelore të legjislacionit bazë për sektorin e energjisë.....	15
KAPITULLI 3	17
Sistemi i Transmisionit në Kosovë.....	17
Përshkrimi i shkurtër i aseteve të Transmisionit në Kosovë	19
Rritja e numrit të aseteve gjatë vitit 2010-2011	19
Mirëmbajtja e Sistemit të Transmisionit	19
Planifikimi i mirëmbajtjes dhe shkalla e realizimit	19
Krahasimi i rënjeve dhe intevenimeve gjatë viteve 2007-2012	20
Indikatorët e performancës së rrjetit transmetues	22
Planifikimi, zhvillimi në rrjetin transmetues dhe investimet	23
Fakte të rëndësishme të zhvillimit të kapaciteteve të Sistemit të Transmisioni	25
Operimi i Sistemit	26
Performanca e Operimit të Sistemit.....	31
Humbjet në rrjetin Transmetues.....	32
Konsumi, diagrami i pikut javor gjatë viteve dhe lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës.....	32
Matja e energjisë dhe zhvillimi i infrastrukturës së telekomunikacionit	34
Infrastruktura telekomunikuese.....	36
Sistemi për monitorim në kohë reale SCADA/EMS.....	37
Tregu i Energjisë Elektrike në Kosovë	40
Zhvillimi i tregut të energjisë elektrike në Kosovë	45
Bashkpunimi dhe integrimi i KOSTT-it në asociacionet dhe mekanizmat regjional	46
Alokimi i kapaciteteve interkonektive.....	47
Siguria e Sistemit, siguria në pune dhe mbrojtja e mjedisit	48
Siguria	48
Mjadisi	48
KAPITULLI 4	49
Zhvillimi i burimeve njerëzore	49
Implementimi i projektit ”zbatimi praktik i menaxhimit të cilësisë bazuar ISO 9001:2008”	51
Teknologjia Informative.....	51
Administrimi i personelit	52
Kujdesi ndaj punëtorëve	52
Menaxhimi i objekteve.....	52
Pergjegjësia Shoqerore Korporative në KOSTT	53
Pasqyra e ngjarjeve më të rëndësishme gjatë vitit 2010	54
Pasqyra e ngjarjeve më të rëndësishme gjatë vitit 2011	58
KAPITULLI 5	63
Raportet e Auditorit 2010	63
Raportet e Auditorit 2011	66
Indeksi i Tabelave.....	69
Indeksi i Figurave	70

Lista e shkurtesave

A	– Amper	ISO	– International Organization for Standardization/ Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
ATR	– Autotransformator	ITC	– Inter TSO Compensation/ Kompenzimi ndërmjet OST-ve
ATSO	– OST e Shqipërisë	KE	– Komisioni Evropian
BE	– Bashkimi Evropian	KEK	– Korporata Energjetike e Kosovës
BKK	– Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	KfW	– Banka Gjermane për Zhvillim
BM	– Balancing Market/ Tregu i Balancuar	KL	– Kualifikim i lartë
CAS	– Computerized Accounting System/ Sistemi i Kompjuterizuar i Kontabilitetit	KOSTT	– Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu
CAO IG	– Coordinated Auction Office Implementation Group – Grupi Implementues për themelimin e Zyrës rajonale për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve	KQKO	– Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale
CMMI-TC	– Congestion Management and Market Integration – Kapaciteti i Transmisionit/ Transmission Capacity	KSHE	– Kryeshef Ekzekutiv
DTEEK	– Dizajni i Tregut të energjisë elektrike të Kosovës	kV	– Kilovolt
EJL	– Evropa Juglindore	KW	– Kilovat
ECLO	– European Commission Liaison Office/ Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian	KWh	– Kilovat-orë
ECS	– Energy Community Secretariat	L	– Gjatësia e linjave
EMS	– Elektromrezha Serbije/ Transmission of Serbia	LP	– Largpërçues
ENTSO-E	– European Network of Transmission System Operators for Electricity/ Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Energjisë Elektrike	M	– Gjinia Mashkullore
EPS	– Elektropriverda Serbije / Elektroekonomia e Serbisë	MEF	– Ministria e Ekonomisë dhe Financave
ETSO	– European Transmission System Operator/ Operatorët Evropian të Sistemit të Transmisionit	MEM	– Ministria e Energjisë dhe Minierave
F	– Gjinia femërore	MVA	– Megavolt-amper
FAT	– Factory Acceptance Test/ Testi pranues i fabrikës	MW	– Megavat
FIDIC	– Fédération Internacionale Des Ingénieurs – Conselis / Federata Ndërkombëtare e Inxhinierëve konsultues	NACMPF	– Network Access Congestion Management Power Flow (nëngrup për menaxhimin e kongjestioneve)
GWh	– Gigavat në orë	NP	– Ndërmarrje publike
HC	– Hidrocentral	NS	– Nënstacion
HVM	– High Voltage Metering/ Matjet e tensionit të lartë	OPEX	– Operational Expenditures/ Shpenzimet operative
		OPGW	– Optical Ground Wire/ Përçuesi i mbrojtjes me Fiber OPTI
		OS	– Operator i Sistemit
		OSSH	– Operator i Sistemit të Shpërndarjes
		OST	– Operator i Sistemit të Transmisionit
		OT	– Operator i Tregut
		PBX	– Pajisjet komutuese për ndërlidhje telefonike
		PK	– Përgatitje e ulët profesionale
		PL	– Përgatitje me shkollë të lartë
		PLC	– Power Line Carrier/ Transmetim me frekuenca të larta
		PMP	– Përgatitje e Mesme Profesionale
		PSP	– Përgatitje Superiore Profesionale
		PSS/E	– Power System Simulator for Engineering/ Simulator për sistemin elektroenergjetik

PSHK	– Pergjegjësia Shoqërore Korporative
PTSC	– Project Team Steering Committee / Komiteti Drejtues i Projektit
PZhST	– Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit
QD	– Qendra Dispečerike
Q.E.D	– Qendra Emergjente Dispečerike
QPT	– Qasje e Palës së Tretë
RG SEE	– Grup rajonal nën ombrellën e MC (Market Committee) – Komiteti i tregut i ENTSO-E i cili do të merret me çështjet e tregut në E.JL
SCADA/EMS	– Supervisory Control and Data Acquisition/Energy/ Management System/ Mbikqyrja, kontrolli dhe grumbullimi i të dhënave/Sistemi për menaxhim të energjisë
SDH	– Synchronous Digital Hierarchy/ Hierarkia Digjitale Sinkrone
SEE	– Sistemi Elektroenergjik
SETSO	– South-East Europe TSO's/OST- të Evropës juglindore
SKK	– Standardet Kosovare të Kontabilitetit
SMM	– Sistemi i Menaxhimit Mjedisor
Sn	– Fuqija e dukshme nominale
SNRF	– Standardet Ndërkombtare të Raportimit Financiar
SSH	– Stabilimente Shpërndarëse
STM-4	– Moduli i transportit sinkron-niveli 4
SHTE	– Shqyrtimi i tarifave të energjisë elektrike
TAS	– Time Attendance System/Sistemi i mbikëqyrjes kohore
TC	– Termocentral
TI	– Teknologjia Informative
TKE	– Traktati i Komunitetit të Energjisë
TL	– Tension i Lartë
TLF	– Transmission Loss Factor/Faktori i humbjeve në Transmision
TSO	– Transmission System Operator/ Operator i Sistemit të Transmisionit
TEEA	– Marrëveshja për Shkëmbimin e Energjisë
UCTE	– Union for Coordination of Transmission of Electricity/Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjisë Elektrike
UCTE OH	– UCTE Operational Handbook (përmbledhje e parimeve dhe rregullave që duhet të zbatohen TSO-të e Europës për operimin e sistemeve elektroenergjetike)
VNM	– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZRrE	– Zyra e Rregullatorit të Enrgjisë

ZNKE – Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

Ngarkesat e OST-së nënkuptojnë ngarkesat e aplikuara nga OST, përfshirë ngarkesat TNUOS, ngarkesat e Operatorit të Sistemit dhe ngarkesat e Operatorit të Tregut.

Ngarkesat TNUoS nënkuptojnë ngarkesat e aplikuara nga OST për shërbimet e sistemit të rrjetit të transmisionit.

Ngarkesat e operatorit të tregut janë ngarkesat e përcaktuara nga OST për ofrimin e shërbimeve të Operatorit të Tregut.

Shfrytëzimi i sistemit do të thotë shfrytëzimi i sistemit të transmisionit të OST-së për bartje të energjisë elektrike nga pikat hyrëse në sistem deri në pikat e furnizimit me shumicë për konsumatorët e Kosovës.

Kapitulli I

Informatat bazë për kompaninë

Emri i regjistruar: Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu – KOSTT sh.a

Adresa e regjistruar: Rr. Iljaz Kodra pn, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Numri i regjistrimit të biznesit: 70325350

Data e themelimit: 1 korrik 2006

Licencat nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë: Licenca për Operim të Sistemit të Transmisionit dhe Licenca për Operim të Tregut të Energjisë Elektrike

Pronari i aksioneve: Republika e Kosovës, implementuar përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik

Kryesues i Bordit të Drejtorëve: Ramadan Paçarada

Kryeshef Ekzekutiv: Fadil Ismajli



Fjala e Kryesuesit të Bordit



Për KOSTT viti 2010-2011 shënon vazhdimin e zhvillimeve pozitive të gjitha aspektet e performancës së kompanisë. Përgjatë kësaj periudhe Bordi i Drejtorëve luajtur një rol proaktiv duke mbështetur menaxhmentin në realizimin e objektivave të përcaktuara me dokumentet e kompanisë, dhe duke zbatuar detyrat fiduciare të përcaktuara me ligjet në fuqi.

KOSTT ka vazhduar punën në drejtim të përmbushjes së objektivave afariste dhe vizionit për të qenë një kompani e vetëqendrueshme financiarisht, dhe duke ofruar shërbime kualitative për klientët e vetë.

Pra, KOSTT me sukses ka realizuar planin e biznesit duke implementuar projektet e parashikuara e të cilat kanë rezultuar me performancë më të mirë teknike, humbje më të vogla dhe furnizim më kualitativ për klientët, dhe të gjitha këto duke respektuar standardet më të larta profesionale në zbatim.

Ndërsa në anën tjetër, KOSTT ka qenë shumë aktiv në revidimin dhe konsolidimin e kornizës ligjore dhe rregullative e cila i përket sferës së vetë. Të gjitha këto pa lënë anash planifikimin e zhvillimit të ardhshëm të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, e të cilat janë parakushte të suksesit, e cili fuqishëm besoj se do të dëshmohet edhe për periudhën e ardhshme.

Ramadan Paçarada

u.d. Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT



Para jush, lexues të nderuar, kësaj radhe sjellim një raport përmbledhës për vitin 2010/2011, duke pasur parasysh se kjo paraqet periudhën pesëvjeçare të funksionimit të KOSTT si operator i pavarur.

Është e njohur se në sektorin e energjisë elektrike rezultatet e angazhimit nuk vërehen menjëherë, dhe në këtë aspekt kemi kënaqësinë që të prezantojmë të arriturat e realizuara gjatë kësaj periudhe. Kështu që ky raport ofron një retrospektivë të qartë të punës së kaluar që nxjerrë në pah rezultatet e punës dhe planifikimit së bërë gjatë pesë viteve të fundit.

Si edhe në vitet e mëparshme, arritjet e KOSTT-it janë rezultat i angazhimit të

mirëfilltë të të gjithë punëtorëve dhe ekipit tonë menaxherial, por që u kurorëzuan me sukses falë mbështetjes institucionale dhe financiare nga akcionari, palët e interesit si dhe qasjes profesionale të Bordit të Drejtorëve në qeverisjen korporative.

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit është një ndër detyrat kryesore të KOSTT. Gjatë vitit 2010 dhe 2011, janë realizuar projekte të rëndësishme të cilat kanë kontribuar në përmbushjen e kësaj detyre. Janë ndërmarrë shumë aktivitete në implementimin e projekteve të reja dhe përfundimin e projekteve në vazhdim siç janë: Nënstacioni Peja 3 me linja, , Nënstacioni Ferizaj 2, Rehabilitimi i NS Kosova A, Transformatorët në Prishtina 4 dhe Kosova A, SCADA EMS dhe shumë projekte të tjera.

Implementimi i suksesshëm i këtyre projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të vendosura nga KOSTT, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat teknike që dalin nga aktet e ENTSO-E.

Performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2010 dhe 2011 ka pasur ngritje të theksuar. Vlen të përmenden disa nga indikatorët themelor të kësaj performance. Në radhë të parë, edhe pse piku është rritur vazhdimisht, sistemi transmetues ka përcjellë zhvillimin e ngarkesës dhe ka mundësuar furnizim me energji elektrike me parametra kualitativ, duke mos cenuar shkallën e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit; energjia e padërguar te konsumi në raport me konsumin e gjithmbarshëm është zvogëluar nga vlera 0.211% në 0.044% në krahasim me vitin 2009. Por, padyshim, reduktimi i dukshëm i humbjeve të energjisë elektrike në vitin 2010 për 33% krahasuar me humbjet e realizuara në vitin paraprak, dhe 12% në vitin 2011 në krahasim me 2010, paraqet një ndër performancat më të rëndësishme të sistemit. Kjo tregon se investimet në rritjen e kapaciteteve të transmisionit, modernizimi i sistemit dhe mirëmbajtja preventive, kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, gjë që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Të gjitha këto rezultate janë evidente, dhe si të tilla vlerësohen lartë edhe nga rrethina afariste e KOSTT. Këtë e dëshmon edhe vlerësimi të cilin e dhanë

këshilltarët e Komisionit Evropian, të cilët në kuadër të vlerësimeve të rezultateve të projekteve me përfituesit e tyre, kanë vlerësuar rezultatet dhe arritjet e KOSTT me notën më të lartë A, në të gjitha kategoritë.

Në anën tjetër, zhvillimi i infrastrukturës fizike është përcjellë edhe me zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe rregullative. Janë shpallur edhe ligjet e reja për sektorin e energjisë, në bazë të të cilave KOSTT ka filluar hartimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe dokumenteve tjera teknike të cilat qeverisin operimin e sistemit.

Për më tepër, KOSTT ka vazhduar angazhimin dhe përgatitjet për të mbështetur projektet për privatizimin e KEK Shpërndarjes dhe Furnizimit dhe projektin për termocentralin Kosova e Re. Po ashtu, KOSTT mbetet i zotuar për ofrimin e qasjes së barabartë në rrjet për të gjithë përdoruesit e sistemit, si dhe mbështetjen për integrimin e energjisë nga burimet e ripërtitshme, në bazë të rregullave të miratuara nga ZRrE.

Edhe për vitin 2011, për të gjashtë herë radhazi, raporti i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare është pa asnjë kualifikim, që reflekton punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve të KOSTT.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për hua me KfW (miratuar nga Parlamenti dhe Presidenti), për zhvillimin e infrastrukturës për ndërtimin e linjës 400 kV Kosovë – Shqipëri, është huaja e parë shtetërore e dhënë për Republikën e Kosovës, e cila më së miri flet për përkushtimin e KOSTT për qëndrueshmëri financiare dhe kredibilitet jo vetëm në vend, por edhe te institucionet financiare ndërkombëtare.

Projekti për linjën 400 kV Kosovë – Shqipëri, paraqet projektin më të madh gjatë 30 viteve të fundit, i cili ndjeshëm do të kontribuoj në optimizimin e sistemeve të të dy vendeve dhe zhvillimit ekonomik.

Falë angazhimit dhe profesionalizmit të të gjithë punëtorëve, KOSTT ka vazhduar të dëshmojë përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale. Është fjala për certifikimin për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO

9001:2008, dhe me këtë, KOSTT bëhet ndërmarrja e parë publike në Kosovë, e certifikuar me këtë standard.

Si edhe deri më tani, do të vazhdojmë me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në rradhë të parë me aksionarët tonë (Qeverinë e Kosovës), me palët e interesuara e posaçërisht me ZRrE, donatorët (Komisioni Evropian, KfW, USAID, etj), OST-të fqinje dhe më gjërë, por edhe me institucionet financiare relevante.

|| KOSTT është dhe mbetet edhe më tutje i përkushtuar për të dhënë kontributin e vet në përshtetimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, në ruajtjen dhe krijimin e vlerave të reja në sistemin elektroenergetik dhe në dobi të vendit.

Përpjekjet tona të vazhdueshme, do të jenë të orientuara drejt përmbushjes së synimeve tona shumë qartë të përcaktuara, zhvillimit dhe punës tonë dhe përgatitjes për një të ardhme të dimensionit evropian.

Fadil Ismajli
Kryshf Ekzekutiv

Harta e Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës




Fig. 1 Harta e Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës

Profili i Kompanisë

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a është themeluar me 1 korrik të vitit 2006 si rrjedhojë e restrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë bazuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore.

KOSTT sh.a është kompani publike 100% në pronësi të Republikës së Kosovës, e mbikëqyrur përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka licencuar KOSTT për të operuar me Sistemin e Transmisionit si dhe Tregun e energjisë elektrike të Kosovës për një periudhë 30 vjeçare me mundësi vazhdimi.


Sistemi i transmisionit të Republikës së Kosovës me të cilin operon KOSTT, edhe pse i vogël, paraqet një nyje shumë të rëndësishme të transmisionit në Ballkan dhe Evropën Juglindore.

Vizioni i KOSTT është që të jetë kompani profitabile, për transmetimin e sigurt dhe stabil të energjisë elektrike, e përgjegjshme ndaj shoqërisë dhe mjedisit, e integruar në mekanizmat evropian.

Misioni i KOSTT është që të siguroj:

- shërbime cilësore duke implementuar të arritura tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- transparencë dhe jo-diskriminim në tregun konkurrues të energjisë elektrike;
- avancim të pozitës në nivelin rajonal dhe evropian përkrahur nga ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore.

KOSTT menaxhon rrjetin e transmisionit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, me gjatësi të përgjithshme prej 1141.305 km.



Qeverisja Korporative

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT sh.a është ndërmarrje publike, pronare e të gjitha aksioneve të së cilës është Republika e Kosovës. Të drejtat e aksionarit të KOSTT ushtrohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Funksioni i qeverisjes korporative të KOSTT si ndërmarrje publike është pakëz më karakteristik në krahasim me korporatat në pronësi private. Si ndërmarrje publike qeverisja dhe veprimtaria e së cilës gjithashtu rregullohet me Ligjin për ndërmarrjet publike, KOSTT ka obligime shtesë të raportimit ndaj Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Në pajtim me Ligjin për ndërmarrje publike (Ligji Nr. 03/L-087) dhe Ligjin për shoqëritë tregtare (Ligji Nr. 02/L-123) Bordi i Drejtorëve të KOSTT në emër të aksionarit ushtron mbikëqyrjen e zhvillimit të afarizmit të KOSTT si dhe performancën e menaxhmentit. Ky funksion ushtrohet nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe miratimit të dokumenteve kyçe me të cilat përcaktohen objektivat strategjike të afarizmit, siç është miratimi i planit të biznesit, buxhetit si dhe rregulloreve dhe akteve tjera të brendshme me të cilat rregullohet veprimtaria e KOSTT.

Puna e bordit ndihmohet nga Komisioni i Auditimit i cili si komision funksional është i themeluar sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe i cili shqyrton paramterat financiar të afarizmit. Bordi gjithashtu ka të drejtë që në rast nevojë të themeloj edhe Komisione të përkohshme me detyra specifike për të këshilluar Bordin në zbatimin e të drejtave dhe përgjegjësisive të përcaktuara me ligj.

Përbërja e Bordit të Drejtorëve gjatë periudhës 2010 – 2011:

1. Ramadan Paçarada, u.d. Kryesues i Bordit të Drejtorëve
2. Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv, Drejtor i Bordit (ex officio)
3. Lutfi Maxhuni, Drejtor i Bordit
4. Faton Deda, Drejtor i Bordit
5. Fadil Rrustemi, Drejtor i Bordit (ka ndërruar jetë me 26 gusht 2010)
6. Fatos Ukaj, Drejtor i Bordit
7. Nazmi Mikullovc, Drejtor i Bordit

Përbërja e Komisionit të Auditimit gjatë periudhës 2010 – 2011:

1. Fadil Rrustemi, Kryesues (ka ndërruar jetë me 26 gusht 2010)
2. Ramadan Paçarada, Anëtarë
3. Fatos Ukaj, Anëtarë /u.d Kryesues pas 26 gusht 2010



Lutfi Maxhuni, Nazmi Mikullovc, Ramadan Paçarada, Fatos Uka dhe Fadil Ismajli.

Kapitulli II

Korniza ligjore dhe rregullative

Ligjet për Energjinë, rregulloret dhe dokumentet tjera relevante të nxjerra në bazë të parimeve të përcaktuara në këto ligje, dhe vendimet e Qeverisë e përbëjnë kornizën ligjore për organizimin dhe menaxhimin e sektorit të energjisë. Ligjet të cilat qeverisin sektorin e energjisë janë në pajtim me normat e Bashkimit Evropian dhe me kërkesat e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjise (TKE).

Në tetor të vitit 2005, në vazhdimësi të procesit të Athinës që kishte për qëllim krijimin e një tregu të integruar rajonal të energjisë në Evropën Jug-Lindore, Komuniteti Evropian dhe Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Rumania, Serbia dhe Kosova nënshkruan Traktatin për themelimin e Komunitetit të Energjisë.

Palët e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë janë zotuar që të zbatojnë pjesë të rëndësishme të *acquis communautaire*, e të cilat si objektivë kanë krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë dhe mekanizmave përkatës. Traktati ka hyrë në fuqi më 1 Korrik 2006.

Në pajtim me Nenin 2 të Traktatit, anëtarët e Komunitetit të Energjisë janë zotuar të:

- (i) Krijojnë një kornizë të qëndrueshme rregullatore dhe të tregut që do të mund të nxisë investimet në rrjetin e gazit, gjenerim të energjisë, dhe rrjetin e transmisionit dhe distribucionit të energjisë elektrike;
- (ii) Krijojnë një hapësirë të vetme rregullatore për tregti me energji ne rrjetat perkatëse;
- (iii) Përmirësojnë sigurinë e furnizimit në një hapësirë të vetme rregullatore;
- (iv) Përmirësojnë aspektin mjedisor në lidhje me energjinë dhe ne rrjetat transmetuese, ngritjen e efciences për energjinë, shfrytëzimin e energjisë së ripërtëritshme dhe kushtet për tregti të energjisë në një hapësirë të vetme rregullatore, dhe
- (v) Zhvillojnë konkurrencën në tregun e energjive që përcillen përmes rrjetave në një shtrirje më të gjerë gjeografike dhe përdorë ekonomitë e shkallës.

Parimet themelore të legjislacionit bazë për sektorin e energjisë

Ligji për Energjinë përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme të cilat qeverisin aktivitetet në sektorin e energjisë në Republikën Kosovës. Parimet e normuara në këto ligje kanë për qëllim garantimin e furnizimit të sigurt e të qëndrueshëm me një cilësi të lartë me energji nëpërmjet një tregu funksional të energjisë. Për më tepër, këto parime kanë për synim promovimin e shfrytëzimit më eficient të energjisë, rritjen e kapaciteteve dhe përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit, si dhe përmirësime në mbrojtjen e mjedisit nga veprimtaritë energjetike.

Ky ligj përcakton edhe detyrimet për hartimin e dokumentit Strategjia e Energjisë i cili është dokumenti themelor që përcakton politikat e energjisë dhe të planifikimit për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë, në përputhje me Strategjinë e Përgjithshme Zhvillimore të Republikës së Kosovës dhe ka për qëllim të:

promovojë konkurrencën në sektorin e energjisë bazuar në parimet e jo-diskriminimit dhe transparencës, përfshirë zhvillimin e tregjeve aktive të shitjes me shumicë dhe pakicë të energjisë brenda Kosovës;

Në bazë të parimeve të përcaktuara në ligjet dhe rregullorët relevante, KOSTT ka zhvilluar legjislacionin sekondar i cili është miratuar nga ZRrE dhe implementohet nga ana e KOSTT dhe palët tjera në sektorin e energjisë elektrike. Parimet e jodiskriminimit dhe transparencës, duke përfshirë edhe krijimin e kushteve për zhvillimin e tregjeve aktive të shitjes me shumicë të energjisë brenda Kosovës janë zbatuar në dokumentet si: Kodi i Rrjetit, Kodi i Matjes, Metodologjia e Taksave për Kyçje në Sistemin e Transmisionit, Kodi i Punës për Qasje në Toka dhe Ndërtesa, Plani Zhvillimor i Transmisionit, Kodi i Pajisjeve Elektrike, Kodi i Standardeve Elektrike, etj.

Ligji për Energjinë Elektrike përcakton rregullat e përgjithshme për kryerjen e aktiviteve të prodhimit, transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike dhe qasjes në interkoneksion, organizimin e qasjes në sistemin e transmisionit dhe sistemit të shpërndarjes, si dhe për funksionimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Qëllimi i këtij ligji është:

- të garantojë kushte për prodhim, transmetim, shpërndarje dhe furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe të përhershëm me energji elektrike, duke iu përmbajtur parimeve të eficiencës së energjisë;

Në bazë të këtij ligji, KOSTT harton propozimin e Dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës, dhe në bazë të parimeve të përcaktuara në këtë dokument dhe në Ligjet për Energjinë gjithashtu harton edhe Rregullat e Tregut.

Ligji për Rregullatorin e Energjisë rregullon funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, si agjenci e pavarur e Republikës së Kosovës, e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas nenit 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ligji përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës për Rregullatorin e Energjisë, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.

Zyra e Rregullatorit për Energji ka përgjegjësi të përkujdeset për funksionimin transparent dhe jodiskriminues të tregjeve të energjisë bazuar në parimet e tregut të lirë sa i përket aktiviteteve konkurruese, dhe rregullimit të aktiviteteve të monopolizuara;

Këto parime të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë si dhe në dokumentet e nxjerra nga ZRrE, zbatohen edhe në dokumentet të cilat KOSTT i harton dhe i implementon pas aprovimit nga ZRrE.

Ky ligj definon se përcaktimi i tarifave të rregulluara për furnizimin me energji do të bëhet sipas një apo më shumë metodologjive të tarifave të cilat hartohen dhe miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Rregullimi i tarifave është trajtuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe bazohet në parimet për reflektimin e kostos në tarifat e furnizimit. Këto tarifa do të reflektojnë plotësisht koston e furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorin fundor nga ndërmarrja përkatëse e energjisë.

KOSTT si Ndërmarrje publike e energjisë i nënshtrohet tarifave të rregulluara për shërbimet të cilat ofron. Në përputhje me parimet e parashikuara në këto ligje, KOSTT dorëzon në Zyrën e Rregullatorit për Energji për shqyrtim dhe miratim propozimet për tarifat e shërbimeve për energji.

Në bazë të këtij obligimi si dhe në bazë të parimeve të përcaktuara si më lartë KOSTT ka hartuar dokumentet:

Metodologjia e ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit TNUoS

- Metodologjia e ngarkesave të operatorit të sistemit
- Metodologjia e ngarkesave të operatorit të tregut
- Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit, i cili është aprovuar nga ZRrE dhe implementohet nga KOSTT.

Kapitulli III

Sistemit i Transmisionit në Kosovë

Përshkrim i shkurtër i aseteve të Transmisionit në Kosovë

Rrjeta e Transmisionit në Kosovë përbëhet nga Linjat dhe nënstationet e nivelit të tensionit të lartë 400kV, 220kV dhe 110kV si dhe asetet tjera për monitorim, kontroll, menaxhim të sistemit të transmisionit.

Sistemi i Transmisionit në Kosovë ka kapacitet instalues te përkah ngarkesën në nivel të vendit deri në 1450MW kurse për momentin kemi ngarkesën e pikut në 1150MW

Në vijim është paraqitur një përshkrim i shkurtër i aseteve bazë dhe vjetërsia e aseteve kryesore në sistemin transmetues të Kosovës. Kapacitetet e linjave të transmisionit në fund të vitit 2011 janë paraqitur në tabelën në vijim.

Linjat Ajrore 2011	Gjithsjetgjatësia në Kosovë (km)	Kapaciteti transmetues $CI=S_n \cdot L$ (MVA km)
400kV	188.497	260879.8
220kV	231.882	105905.1
110kV	759.152*	86679.98*

Tab. 1 Gjatësia e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre

*këtu janë përfshi edhe gjatësia dhe kapacitetet transmetuese të LP1813 (NS Ferizaj 2-NS Gjilani 5 e cila është e gatshme për operim.



Vjetërsia e linjave sipas nivelit të tensionit është dhënë në tabelen.2.

Numri	Mosha (vite)	Nikeli 400kV	Nikeli 220kV	Nikeli 110kV
1	0 - 25	0	15%	30%
2	25 - 35	43%	70%	20%
3	35 - 50	57%	15%	50%

Tab. 2 Vjetërsia e linjave të rrjetit të KOSTT për vitin 2011




Fig. 2 Vjetësia e linjave e shprehur në përqindje

Nga të dhënat e paraqitura më lartë rezulton që nga kapaciteti i gjithë mbarëshëm i instalimit, 22% janë të moshës 0-25 vite, 33% janë nga 25-35 vite dhe 33% mbi moshën 35 vite.

Kapacitetet aktuale transformuese të rrjetit të transmisionit të KOSTT janë të koncentruara në nënstationet 400/220/110kV dhe 220/110kV. Ne tabelën 3 janë paraqitur kapacitetet transformuese në shfrytëzim në vitin 2011.

Autotransformatorët	Niveli i tensionit (kV)	Nr. i Autotransformatorëve	Kapaciteti i përgjithshëm (MVA)
NS Kosova B	400/220 kV	3	3x400=1200MVA
NS Peja 3	400/110	1	1x300=300MVA
NS Ferizaj 2	400/110	1	1x300=300MVA
400/220/110kV		4	Gjithsejtë 1800MVA
NS Kosova A	220/110	3	3x150=450MVA
NS Prishtina4	220/110	3	3x150=450MVA
NS Prizreni 2	220/110	2	2x150=300MVA
Kapaciteti i Përgjithshëm per nivel tensioni (kV)	220/110	8	Gjithsejtë 1200MVA

Tab. 3 Kapacitetet transformuese të rrjetit të KOSTT-it për vitin 2011

Ndërlidhja e fuqishme me shtetet fqinje bënë që KOSTT të jetë shumë i rëndësishëm nga aspekti i sigurisë së operimit dhe besueshmërisë së sistemit.

Aktualisht rrjeti transmetues i Kosovës është i ndërlidhur me 5 linja interkonektive me shtetet fqinje. Në këto linja në formë transiti kalojnë sasi të mëdha të energjisë. Në tabelën 4. janë dhënë kapacitetet e linjave të interkonksionit me shtetet fqinje.



Linja	Tensioni (kV)	Fuqia natyrore (MVA)	NTC Sn	(MVA)
LP 407 NS Kosova B - NS Nish	400	500	500	1317
LP 437/2 NS Peja 3 - NS Ribarevina	400	500	400	1317
LP 420/2 NS Ferizaj 2 - NS Shkupi 5	400	500	400*	1317
LP 2303 NS Prizreni 2 - NS Fierza	220	120	210*	300
LP 205/2 NS Podujeva - NS Krushevc	220	120	100	300

Tab. 4 Kapacitetet e linjave të interkonjeksionit deri në vitin 2011

* NTC janë marrë nga https://www.entsoe.eu/fileadmin/user_upload/_library/ntc/archive/NTC-Values-winter-2010-2011.pdf

Në figurën 3 është paraqitur në formë të përmblendhur numri i elementeve të rrjetit të transmisionit sipas nivelit të tensionit për vitin 2011.




Fig. 3 Numri i asetëve sipas nivelit të tensionit për vitin 2011

Rritja e numrit të aseteve gjatë vitit 2010-2011

Në rrjetin e transmissioinit kanë vazhduar investime kapitale të cilat kanë për qëllim rritjen e sigurisë dhe performancës së operimit të sistemin elektroenergjetik. Këto investime kanë ndikuar në rritjen e kapacitetit fizik të transmissioinit dhe të bazës së aseteve të kompanisë. Në vijim është paraqitur krahasimi i aseteve për vitet 2010 dhe 2011. Në këtë rast numri i Autotransformatorëve është paraqitur sipas tensionit primar.




Fig. 4 Krahasimi i aseteve të rrjetit të KOSTT për vitet 2010 dhe 2011

Mirëmbajtja e Sistemit të Transmissioinit

Mirëmbajtja e Sistemit të Transmissioinit është një program i planeve ku përfshihen: inspektimi gjendjes, monitorimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektroenergjetike. I tërë ky aktivitet ka për qëllim të siguroj operimin e pajisjeve elektroenergjetike në norma të kërkuara, minimizimin e prishjeve në sistem, dhe parandalimin e dëmtimeve të pajisjeve për të mundësuar shfrytëzimin efikas të tyre deri në fund të jetës. Planifikimi i mirë i mirëmbajtjes është bazë për një mirëmbajtje cilësore dhe efektive.

Qëllimi kryesor i mirëmbajtjes është që nëpërmjet monitorimit të rregullt të zbulojë dhe eliminoj burimet e problemeve potenciale para se ato të ndodhin. Kështu që nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit adekuat të mirëmbajtjes KOSTT

ka arritur të realizoj dhe mbaj një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe sigurisë në sistemin elektroenergjetik.

|| Prioritet i KOSTT mbetet që të avancojë sistemin e mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta të cilat kanë filluar të aplikohen në sistemet e zhvilluara

Planifikimi i mirëmbajtjes dhe shkalla e realizimit

Pjesë shumë e rëndësishme e funksionimit dhe mirëmbajtjes efektive të stabilimenteve elektroenergjetike është planifikimi i mirë i mirëmbajtjes. Planifikimi i mirëmbajtjes realizohet në bazë të informacioneve të mbledhura nga sistemi, politikës për mirëmbajtje dhe rekomandimeve të prodhuesve. Mbi bazën e këtyre të dhënave zhvillohet programi i mirëmbajtjes i cili përmban remontet dhe shqyrtimet e rregullta të çdo pajisje. Mirëmbajtja në KOSTT implementohet në pajtim me Politikën e Mirëmbajtjes ku definojnë intervalet kohore dhe llojet e aktiviteteve të mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet në sistem konform obligimeve në respektimin e rregullave, normave dhe kodeve teknike.

Në vazhdimin është paraqitur plani dhe realizimi i mirëmbajtjes për vitin 2011.



Fig. 5 Krahasimi i planifikimit me realizim për LP në vitin 2011




Fig. 6 Krahasimi i planifikimit me realizim për NS në vitin 2011

Krahasimi i rënieve dhe intervenimeve gjatë viteve 2007-2011

Trendi i zvogëlimit të intervenimeve si rezultat i mirëmbajtjes preventive dhe investimeve ka vazhduar dhe mund të shihet në figurën e mëposhtme.




Fig. 7 Krahasimi i intervenimeve në nënstacione për vitet 2007-2011




Fig. 8 Krahasimi i intervenimeve në linja për vitet 2007-2011

Në diagramin në fig 7 dhe fig 8 janë dhënë krahasimet e rënieve të linjave dhe transformatorëve për tri vitet e fundit. Numri i rënieve në linja për vitin 2010 dhe 2011 ka pasur trend të uljes. Meqenëse është e pamundur që të eliminohen prishjet në sistem, atëherë përmes mirëmbajtjes preventive tentohet vazhdimisht të mbahet siguria e operimit në nivel të lartë dhe njëkohësisht duke mbajtur nivelin e rënjeve në minimum. Në këtë mënyrë sigurohet që energjia e pafurnizuar nga KOSTT të jetë minimale.



Në bazë të statistikave dhe mundësive teknike prishjet ndodhin më së shumti në linja. Në vijim janë dhënë krahasimet e rënieve të linjave sipas nivelit të tensioneve përgjatë viteve 2009/2010/2011.

Në vitin 2010/2011 nuk ka pasur rënie të Transformatorëve energjetikë për shkak të prishjeve në Tranformatorë dhe elementet përcjellëse.




Fig. 9 Krahasimi i rënieve të LP-ve 2009-2011



Indikatorët e Performancës së rrjetit Transmetues

Performanca pozitive e operimit të transmissioinit reflektohet edhe në llogaritjet e indikatorëve të performancës që raportohet çdo tre muaj në ZRrE.

KOSTT raporton Indikatorët e performancës në ZRrE në mënyrë të vazhdueshme. Krahasimi i indikatorëve kyç të performancës sipas viteve është paraqitur si më poshtë



*STL - Stabilimente te Tensionit te Larte

Fig. 10 Numri i prishjeve në Stabilimente të Tensionit të lartë(STL) në 100 fusha





Fig.11 Koha mesatare e riparimit të prishjes në linja gjatë viteve 2009-2011




Fig 12. Koha mesatare e riparimit të prishjes në fusha në nënstatione gjate viteve 2009-2011

Planifikimi, Zhvillimi në Rrjetin Transmetues dhe Investimet

Sistemi i Transmisionit paraqet një ndër shtyllat kryesore të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës. Planifikimi dhe zhvillimi sipas normave të kërkuara i Sistemit Transmetues është themelor në zhvillimin e sektorit elektroenergjetik dhe krijimin e kushteve për përkrahjen e tregut të energjisë elektrike. Objektiva kryesore e planifikimit dhe zhvillimit të sistemit të transmisionit është krijimi i infrastrukturës për përkrahje të rritjes së kërkesës, siguria e furnizimit, ndërtimi i njësive të reja gjeneruese dhe përkrahja e zhvillimit të tregut të energjisë. Rrjeti i transmisionit i Republikës së Kosovës gjatë 50 viteve është zhvilluar në disa faza ku perfshihet faza e zgjerimit të rrjetit, përforcimit dhe vendosjes së teknologjisë së re për plotësimin e standardeve të operimit.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve thelbësore në ngritjen e kapaciteteve, besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit transmetues të kryera gjatë vitit 2009 në KOSTT, edhe viti 2010 dhe 2011 është përcjellë me dinamikë të lartë për realizimin e projekteve të filluara gjatë vitit 2009-2010 dhe projekteve të reja në pajtueshmëri me Planin Zhvillimor të Transmisionit (2011-2021) i aprovuar nga ZRrE.

Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së Sistemit Transmetues është orientuar në katër kategori të ndryshme të zhvillimit të projekteve:

- Rritja e kapaciteteve të Rrjetit Transmetues.
- Ri-vitalizimi i nënstacioneve dhe pajisjeve të tensionit të lartë.
- Sistemet mbështetëse në operim të Sistemit (SCADA/EMS, grupet matëse, shërbimet ndihmëse, modernizimi i mbrojtjeve rele etj)
- Përkrahja e ngarkesës dhe gjenerimit (aplikacionet e kyçjes në Rrjetin e Transmisionit).

Gjatë vitit 2010 dhe 2011 janë implementuar dhe lëshuar në punë projekte të rëndësishme, të cilat kanë ndikuar në ngritje të mëtutjeshme të besueshmërisë dhe sigurisë së Sistemit të Transmisionit. Në vijim janë paraqitur projektet e përfunduara, të cilat kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në ngritje të kapacitetit transmetues:

- Rindërtimi i linjës 110kV, nr 212 me gjatësi 37km , NS Kosova A- NS Ferizaj 1,
- Ndërtimi i linjës së re 110kV me gjatësi 18.5km, NS Klina - NS Peja 3 (në kuadër të Paket Projektit Peja 3)

- Instalimi i autotransformatorit të tretë 150MVA, në NS 220/110 kV – Prishtina 4

Në kategorinë e projekteve për ri-vitalizimin e nënstacioneve dhe pajisjeve të tensionit të lartë të realizuar në vitin 2010 dhe 2011 janë projektet e poshtëshënuara të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së operimit të Sistemit të Transmisionit:

- Ri-vitalizimi i tërësishëm i NS 220/110 kV – Kosova A,
- Ri-vitalizimi i NS Prishtina 1 (pajisjet e tensionit të lartë 110kV),
- Ri-vitalizimi i pajisjeve të tensionit 220kV dhe 400kV në NS 400/220 kV – Kosova B,
- Motorizimi i ndarësve 110kV, parapraakisht pa ngasje motorike.
- Ndërtimi i NS. 110/10(20) kV Skenderaj (në kuadër të Paket Projektit Peja 3),
- Ndërtimi i Nënstacionit të ri 400/110 kV Ferizaj 2, 300 MVA, së bashku me linjat ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, që lidhin këtë nënstacion me NS Kosova B, NS Shkupi 5, NS Kosova A, NS Bibaj (dy linja 110 kV), NS Sharri dhe NS Gjilani 5,
- Ndërtimi i përçuesit në LP 110kV NS Peja 1 – NS Peja 2

Projektet mbështetëse të Sistemit të Transmisionit të realizuara gjatë vitit 2010 dhe 2011 janë paraqitur në vijim:

- Implementimi dhe zyrtarizimi i grupeve matëse në kufi (NS Kosova A)
 - Ndërtimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110kV Prishtina 2 dhe NS Prishtina 3
 - Implementimi i projektit SCADA/EMS & Telekomunikacioni
 - Instalimi i Sistemit të Teknologjisë Informative për Operatorin e Tregut,

Në KOSTT gjatë vitit 2010 dhe 2011 janë pranuar gjithsej nëntë aplikacione për kyçe në rrjetin e Transmisionit, të cilat janë shqyrtuar në bazë të Metodologjisë së Tarifave të Kyçjes, në pajtueshmëri të plotë me kërkesat që dalin nga Kodi i Rrjetit, respektivisht Kodi i Planifikimit. Në vijim janë paraqitur aplikacionet e pranuar dhe të shqyrtuara në vitin 2010-2011:

- Kyçja e Gjeneratorëve me Erë, 30MW, 20/110kV, Air –Energy – KITKA
- Kyçja e NS. Gjilani 5, 2x40MVA, 110/10(20)kV
- Kyçja e NS Prishtina 7, 2x40MVA, 110/10(20)kV
- Instalimi i transformatorit 63MVA, 110/10kV ne NS Prishtina 2
- Instalimi i transformatorit 63MVA, 110/35kV ne NS Prishtina 1
- Instalimi i transformatorit 40MVA, 110/35/10kV ne NS Peja 1
- Instalimi i transformatorit 40MVA, 110/35/10kV ne NS Ferizaj 1
- Instalimi i transformatorit 40MVA, 110/10kV ne NS Prizreni 1
- Kyçja e NS Prishtina 6, 2x40MVA, 110/10kV

Një numër i konsiderueshëm i projekteve kanë filluar gjatë vitit 2011 dhe përfundojnë gjatë vitit 2012. Realizimi i projekteve të bartura në vitin 2012 do të ndikojnë në ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të transmisionit në pajtueshmëri me kriteret teknike që dalin nga Kodi i Rrjetit, si dhe kërkesave teknike të përshkruara në doracakun operativ të ENTSO-E.

Projektet, të cilat kanë filluar implementimin gjatë vitit 2011 janë:

- Instalimi i Autotransformatorit të tretë 150MVA dhe ndërimi i pajisjeve të tensionit të lartë në NS. 220/110 kV Prizren 2,
- Ndërimi i përçuesve në linjat 110kV NS Vushtrri 1- NS Shipkovc-NS Vallaq (LP 125/2 dhe LP 125/3)
- Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP 112
- Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër , 179/1, 1801 (ndërimi i izolatorëve dhe urave përçuese)
- Rialokimi i linjës 110kV, nr 1806 , NS Gjakova 1 - NS Gjakova 2 & Ndërimi i pajisjeve të TL 110kV në NS Gjakova 1
- Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetanake në NS KOS B
- Rehabilitimi i pajisjeve të TL 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1
- Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110kV në NS PZ 2
- Ndarja e zbarrave në dy seksione në NS Gjilani 1 dhe NS Theranda





Fakte të rëndësishme të zhvillimit të Kapaciteteve të Sistemit të Transmisionit

Projektet e realizuara gjatë vitit 2010/2011 në zhvillimin e rrjetit Transmetues në KOSTT të referuara në Planin Zhvillimor të Transmisionit, paraqesin projekte shumë të rëndësishme me ndikim në ngritjen e performancës operuese të Sistemit të Transmisionit. Implementimi i suksesshëm i këtyre projekteve ka ndikuar në përmbushjen e objektivave themelore të vendosura nga KOSTT të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat teknike që dalin nga aktet e ENTSO-E.

Procesi i Implementimit të projekteve në zhvillimin e rrjetit dhe infrastrukturës përcjellëse (Komunikimi , monitorimi etj) gjatë vitit 2010/2011 është karakterizuar me dinamikë të lartë të aktiviteteve dhe është realizuar pa cënuar sigurinë e sistemit transmetues. Mbajtja e sigurisë së sistemit përkundër shkyçjeve të shumta për shkak të projekteve është bërë e mundur si rezultat i vënjes në operim të projekteve kryesore të kryera gjatë vitit 2009 dhe 2010, siç është projekti Peja 3 400/110kV, transformatori i tretë në NS Kosova A 220/110kV, etj, riaftësimi dhe transformimi i linjës së tensionit 220kV LP212 në linjë të tensionit 110kV që ndërlidh nënstationet Kosova A-Ferizaj 1

|| Kapaciteti i rrjetit të transmisionit për konsumin e brendshëm në fund të vitit 2011 është ngritur për 12.4% në krahasim me fillimin e vitit 2010, kurse në raport me vitin 2009 për 56%. Kapaciteti i rrjetit bazuar në kriterin N-1 gjithashtu është ngritur për 19% për periudhën 2010/2011, kurse në raport me vitin 2009 për 62.7%.






Fig. 13 Rritja e kapacitetit të rrjetës së Transmisionit

Ne fig.13. është pasqyruar zhvillimi i kapaciteteve transmetuese në periudha të shkurtëra tremujore nga viti 2009 deri në fund të vitit 2011



Fig. 14 Zhvillimi i kapacitetit sipas viteve

Projektet e implementuara gjatë viteve 2010-2011 kanë ndikuar në ngritjen e kualitetit të furnizimit të konsumit e me të cilat profili i tensionit në nivelin e tensionit 110kV është përmirësuar dukshëm.




Fig. 15 Përmirësimi i profilit të tensionit në nivelin e tensionit 110kV

Ngritja e profilit të tensioneve dhe optimizimi i rrjedhave të fuqisë ka ndikuar në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në vitin 2011 për 51% krahasuar me humbjet e realizuara në vitin 2009.



Operimi i sistemit

Operimi i Sistemit kryen proceset e planifikimit afatmesëm dhe afatshkurtër, analizat e operimit të sistemit, monitorimin dhe kontrollimin e rrjedhave të fuqisë në SEE të Kosovës. I tërë ky proces bëhet me qëllim të operimit të sigurtë dhe të besueshëm të sistemit vazhdimisht 24 orë gjatë 365 ditëve.

Operatori i Sistemit, nëpërmjet planifikimit dhe operimit siguron që në vazhdimësi të realizohet furnizim kualitativ i konsumatorëve, me parametra teknik si tension dhe frekuencë, në përputhje me kodet teknike në fuqi. Poashtu, gjatë gjithë kohës siguron punën sinkrone me TSO-të tjera, si dhe ofron shërbimet e sistemit.

Me qëllim të krijimit të kushteve për tregun e energjisë elektrike, OS kryen kalkulimet e kapaciteteve transmetuese interkonektive në disponim.

Nga Qendra Nationale Dispeçerike monitorohen dhe kontrollohen rrjedhat e fuqisë nëpër rrjetin transmetues të Kosovës, duke dhënë instruksionet e nevojshme palëve të treta të kyçura në SEE të Kosovës.

Meqenëse energjia elektrike nuk ka mundësi deponimi, pra prodhimi duhet të jetë i barabartë me ngarkesën, OS nëpërmjet mekanizmave të balancimit në disponim, i mban parametrat teknik në kufijtë e operimit të sigurtë. Për këtë qëllim përdoren shërbimet ndihmëse të nevojshme, si rezerva primare, sekondare dhe terciare. Këto shërbime i mundësojnë palëve në treg, siç janë gjenerimi dhe distribucioni, që të zhvillojnë operimet e tyre në mënyrë sa më të besueshme, në aspektin teknik dhe ekonomik.

KOSTT në baza vjetore bën përpilimin e parashikimit të bilansit elektroenergjetik njëvjeçar, dhe planifikimin afatgjatë për zgjerimin e rrjetit transmetues.

Me qëllim të mbajtjes së një furnizimi kualitativ të konsumatorëve, Qendra Dispeçerike Nationale koordinon mirëmbajtjen, në aspektin e planifikimit dhe implementimit në kohë reale, për pjesën e rrjetit në SEE të Kosovës.

Operimi i sistemit bazohet në tri objektiva kryesore:

- Të mundësojë operim të sigurtë dhe me besueshmëri të lartë të sistemit elektroenergjetik
- Të mundësojë operimin ekonomik të sistemit dhe të mundësojë tregun e energjisë
- Të mundësojë aranzhimet kontraktuale sipas programit D-1

Operimi i sistemit duhet të garantojë punë të sigurtë me besueshmëri të lartë të sistemit duke kontrolluar zhvillimet e mundëshme në sistem dhe veprimet në sistem përballë kontigjencave të ndryshme siç janë: lidhjet e shkurtëra, ndryshimet e papritura të ngarkesës, rënja e gjeneratorit nga puna etj. Nëpërmjet monitorimit të punës si dhe kontrollit të sistemit bëhet i mundur parashikimi i rrishtit, me q'rast ndërmerren masat efektive preventive për të minimizuar zgjerimin e ndodhive ashtu që sistemi mos të degradojë deri në rënje totale (black out).



KOSTT përmes shërbimeve të ofruara nga operimi i sistemit është i orientuar që të sigurojë punë të njëkohshme, të sigurtë dhe të besueshme për të gjitha palët që janë pjesë përbërëse e sistemit elektroenergjetik. Poashtu ofron edhe shërbimet tjera përcjellëse për gjeneratorët, furnizuesit dhe konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmisionit.

Meqenëse menaxhimi i sistemit elektroenergjetik dhe energjisë elektrike është mjaft kompleks për shkak të natyrës së veçant, KOSTT nëpërmjet ekipeve përgjegjëse për menxhimin dhe operimin e sistemit në fazën planifikuese dhe në kohën reale, sigurojnë në mënyrë të vazhdueshme furnizimin e sigurt dhe kualitativ të konsumatorëve, duke mirëmbajtur kriteret e kualitetit të parametrave elektrik si tensioni, frekuenca dhe siguria e sistemit.

Përgjegjësinë e realizimit të operimit të sistemit në kohë reale e mban Qendra Dispecerike Nacionale. Përmes QND është i mundur menaxhimi i flukseve të fuqisë dhe profileve të tensionit në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, duke menaxhuar përmbushjen e lakores së kërkesës së konsumit dhe programit të shkëmbimit, me kombinimin e njëkohshëm të prodhimit të energjisë nga gjeneratorët dhe importin / eksportin.

Në vitin 2010, 2011 përkatesisht në tabelen.5 janë paraqitur të dhënat sipas balancës së realizuar: Prodhimi i HC Lumbardhi nuk përfshihet në gjenerimin total, pasi që nuk është i kyçur në rrjetin e transmisionit.

Nga tabela 5. shihet se prodhimi i energjisë elektrike krahasuar me vitin 2010 është rritur për 3,6%. Konsumi gjithashtu ka rritje për 2,7%. Humbjet e energjisë elektrike në transmision janë zvogëluar për 12% krahasuar me vitin 2010.

	Mwh	2010	2011	2011/2010*100	
Gjenerimi	Hidro Gjenerimi (Neto)	(H)	113.861	74.387	65.33
	HC Lumbardhi		36.083	22.304	61.81
	HC UJMANI		113.861	74.387	65.33
	Termo Gjenerimi (Neto)	(T)	5.010.420	5.234.629	104.47
	TC Kosova A		1.739.815	2.014.450	115.79
	TC Kosova B		3.270.605	3.220.180	98.46
Total Gjenerimi (Neto)	2 = (H) + (T)	5.124.281	5.309.016	103.61	
Shkëmbimi	Total Rrjedhat fizike Dërgim (+)	(D)	3.113.256	2.717.198	87.28
	Total Rrjedhat fizike Marrje (-)	(R)	3.583.179	3.134.947	87.49
	Total Neto Balanci i Shkëmbimeve	3 = (D) - (R)	-469.923	-417.749	88.90
	Hyrjet në transmision	4 = (2+R)	8.707.459	8.443.963	96.97
KOSTT	Konsumi vetiak i Transmisionit	5	0	0	
	Humbjet në Transmision	6	131.043	115.316	88.00
	Cons. vetiak + Humbjet në %	$((5+6) / 4) \%$	1.50	1.37	90.74
	Energjia e dërguar nga Transmisioni (1)	7 = (2-3-5-6)	5.463.161	5.611.449	102.71
	Energjia e dërguar nga Interkonekcionit	(D)	3.113.256	2.717.198	87.28
	Energjia dërguar Distribuonit	(a)	4.432.328	4.524.192	102.07
	Shpenzimet e gjenerimit nga transmisioni *	(b)	314.048	406.925	129.57
	Kosova Thengjilli	(c)	14.737	0	0.00
	Energjia Dërguar kons.direkt e të kualifik.	(d)	702.047	680.332	96.91
	New Co Ferronikell		621.073	597.269	96.17
	Shari		59.757	59.962	100.34
	Trepça		21.217	23.101	108.88
	Barazimi (Settlements) në Dërgim (2)	(a+b+c+d)	5.463.161	5.611.449	102.71
Total energjia e dërguar nga Transmisioni	(a+b+c+d+D)	8.576.417	8.328.647	97.11	
Ngarkesa maksimale (MW)		1.156	1.150	99.48	
Kërkesa (Konsumi bruto) i Kosovës	(2-3)	5.594.203	5.726.765	102.37	

Tab. 5 Balanca e realizuar 2010/2011

*Shpenzimet e gjenerimit nga transmisioni janë: TS PALAJ, LP 290, B1, B2, T34, T35, T45, MIHJET, TERPTORJA, SEPARACIONI

Në tabelën 6. janë paraqitur importet dhe eksportet sipas programit, duke i përfshirë edhe shkëmbimet e energjisë elektrike.

Mwh	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTAL
Dhënje sipas programit (Eksport+shkëmbim) 2010	0	2.180	16.655	22.015	43.227	116.492	10.158	18.754	65.490	44.628	9.770	3.102	352.471
Marrje sipas programit (Import+shëmbim) 2010	151.860	108.475	51.060	81.099	18.905	8.260	120.910	58.995	6.620	54.253	96.615	61.335	818.387
Dhënje sipas programit (Eksport+shkëmbim) 2011	5.636	3.880	17.471	6.946	19.293	111.518	137.145	50.075	12.590	6.260	350	0	371.164
Marrje sipas programit (Import+shëmbim) 2011	102.500	74.950	47.210	77.490	56.090	4.350	1.780	20.055	57.835	115.005	155.162	103.772	816.199

Tab. 6 Importi dhe eksporti 2010/2011

Të dhënat nga tabela janë paraqitur edhe në formë diagrami.




Fig. 16 Importi dhe shkëmbimet 2010, 2011




Fig. 17 Eksporti dhe shkëmbimet 2010, 2011



Performanca e Operimit të sistemit

Performanca e operimit të sistemit në vitet 2010/2011 ka pasur ngritje të theksuar. Të gjithë treguesit e performancës kanë treguar një performancë të kënaqëshme në raport me vitet paraprake. Indikatorët themelor të performancës siç janë: Energjia e pafurnizuar, numri i ankesave të konsumatorëve, kualiteti i tensionit dhe humbjet e energjisë kanë vlera më të vogla se në vitet paraprake, si rezultat i rritjes së disponueshmërisë së rrjetit të transmisionit. Në tabelën.7. janë dhënë indikatorët e performancës.

	Indikatori	2010 Janar - Dhjetor	2011 Janar - Dhjetor	2011/2010 %
T1	Energjia e transmetuar (GWh)	8707,43	8443,97	96,97
T2	Piku Koincident (MW)	1156	1150	99,48
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	181,815	188,49	103,67
		231,882	231,83	99,98
		672,1085	764,94	113,81
T4	MVA-km	239450	248249	103,67
		77506	77506	100,00
		78279	83209	106,30
T5	Kapaciteti i transformatorëve	1500	1800	120,00
		1050	1200	114,29
T6	Kapaciteti i disponueshëm mesatar import/eksport (AATC)			
T7	Kapaciteti i disponueshëm maksimal import/eksport (MATC)			
T8	Pagesa për kongestion			
T9	Koha mesatare e rënjes (AIT minuta/vit)	230,25	157,82	68,54
T10	Numri i ankesave për tension	8	2	25,00
T11	Ankesat e zgjidhura për tension	8	2	25,00
T12	Numri i ankesave për matje	0,00	0	
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	0,00	0	
T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/hour)	17,84	21,38	119,93
		15,53	21,89	141,01
T15	Humbjet në transmision (Gwh)	131,03	115,31	88,01

Tab. 7 Indikatorët e performances 2010/2011




Fig. 18 Energjia e pafurnizuar 2007, 2008, 2009, 2010, 2011

Humbjet në Rrjetin Transmetues

Zhvillimi i rrjetit transmetues, operimi duke përdorur metodat optimale, mirëmbajtja efektive kanë ndikuar në rritjen e performancës së sistemit transmetues, gjegjësisht zvoglimin e humbjeve teknike në sistem. Humbjet janë zvogluar në mënyrë të vazhdueshme edhe në vitet 2010 dhe 2011. Diferenca e zvoglimit të humbjeve nga viti 2009 me vitin 2010 është 44GWh, kurse nga viti 2010 në vitin 2011 është 16GWh. Përqindja e humbjeve llogaritet në raport me energjinë e tërë e cila hyn në rrjetin e transmisionit. Këto të dhëna janë paraqitur në fig.19.

Nga këndvështrimi ekonomik gjatë dy viteve 2010 dhe 2011 janë kursyer rreth 1.9 mil Euro si rrjedhojë e zvogëlimit të humbjeve në rrjetin e transmisionit.



Fig. 19 Humbjet në transmision 2006-2011

Konsumi, Diagrami i Pikut javor gjatë viteve dhe lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës

Konsumi i energjisë elektrike dhe piku i ngarkesës gjatë viteve 2006/2011 kanë trend të rritjes. Ky trend i rritjes shihet në Fig.20.



Fig. 20 Konsumi dhe piku 2006-2011

Ndërsa piku javor për tre vite është dhënë në Fig.21. Në fig.21 janë paraqitur lakoret të cilat shprehin pikun javor për vitet 2009, 2010, 2011.




Fig. 21 Piku javor 2009, 2010, 2011

Karakteristika e konsumit shprehet përmes lakores së kohëzgjatjes së ngarkesës. Kjo lakore shprehë marrëdhënjen ndërmjet konsumit dhe kohës dhe njëherit përcakton intervalin kohor sa zgjatë një konsum karakteristik. Në fig.22 janë dhënë lakoret e kohëzgjatjes së ngarkesës për sistemin elektroenergjetik të Kosovës.




Fig. 22 Lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës 2009, 2010, 2011

Lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës është paraqitur për gjatë 8760 orë të vitit 2011 duke filluar prej ngarkesës maksimale (1150 MW) me radhë deri te ngarkesa minimale vjetore (173 MW). Me ngarkesë maksimale (ngarkesa e pikut) mbi 950 MW kanë qenë 540 orë gjatë vitit ose 6,16% e të gjitha orëve të vitit. Ngarkesa variable është ndërmjet 400MW deri në 950 MW, gjithësejt 7388 orë në vit, ose 84,33%. Me ngarkesë minimale më të vogël se 400 MW janë 832 orë ose 9,49%.

Trendi i rritjes së konsumit reflektohet edhe përgjatë muajve të viteve succesive. Një diagram i tillë shihet në fig.23.






Fig. 23 Paraqitja në përqindje e rritjes së konsumit për vitin 2011 ndaj 2010 dhe 2010 ndaj 2009

Matja e Energjisë dhe Zhvillimi i infrastrukturës së telekomunikacionit

Matja e energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit të KOSTT-it (400kV, 220kV dhe 110kV) realizohet nëpërmjet transformatorëve matës (të rrymës dhe të tensionit) si dhe me njehsorë multi-funksional Landis & Gyr të tipit ZMQ, me klasë të lartë saktësie që është në pajtim të plotë me kërkesat që dalin nga Kodi i Matjes.

Infrastruktura teknike e grupeve matëse në rrjetën e transmisionit të KOSTT-it për çdo vit po begatohet me pajisje të reja duke garantuar matje kualitative bazuar në standarde të kërkuara. Kjo është bërë në bazë të projekteve të reja që janë realizuar dhe planifikohen të realizohen në një të ardhme të afërt në KOSTT.

Edhe gjatë vitit 2010/2011, janë bërë ndryshime të shumta në grupet matëse në rrjetën e transmisionit me qëllim të plotësimit të kërkesave që dalin nga Kodi i Matjes.

Gjatë këtyre viteve janë realizuar dhe instaluar grupe matëse të ndryshme si rrjedhojë e projekteve të reja të zhvilluara në KOSTT.

Gjatë vitit 2010/2011, Sektori i Matjeve ka realizuar testimin periodik të Grupeve Matëse me Instrument Testues PWS 2.3 Plus (kl. 0.1) në: 30 prej 32 nënstationeve.

Plani i testimit të grupeve matëse në NS Distributive është realizuar 93,75%. Ka mbetur pa u kontrolluar vetëm grupet matëse në NS Vallaçi dhe grupet matëse në HC Ujmani.

Gjatë vitit kalendarik 2011 janë testuar dhe kontrolluar grupet matëse në linjat interkonektive përmes Etalonit Testues PTS 400.3 (kl. 0.02) në të dyja anët e linjës. Linjat e përfshira në këtë testim janë:

- LP 437/2, këmbimi i energjisë elektrike Kosovë – Mali i Zi (KOSTT – CGES); dhe
- LP 420/2, këmbimi i energjisë elektrike Kosovë – Maqedoni (KOSTT – MEPSO).


Me rastin e lëshimit në operim të linjës 420/2 në NS Ferizaji 2 është kontroluar, testuar me Etalon dhe njëkohësisht është zyrtarizuar Grupi i Ri matës. Ndërsa, është bërë matja e Impedancës së linjës në territorin e secilit shtet, dhe janë përvetsuar vlerat e koeficienteve për transferimin e energjive të këmbjera në kufi.

Të gjitha rezultatet e fituara nga këto testime me PWS 2,3Plus(kl.0.1) dhe Etallon PTS 400.3 (kl. 0.02) kanë rezultuar brenda brezit/kufirit të lejuar të matjes.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të komunikimit dhe modernizimit të GM janë zëvendësuar njehsorët e tipit ZMU me njehsorë të ri ZMQ, dhe atë në këto nënstacione:

NS Prishtina 5, njehsorët për TR-1 dhe TR-2;

- NS Peja 2, njehsorët për TR-1 dhe TR-2;
- NS Vushtrria 2, njehsorët për TR-1 dhe TR-2;
- NS Podujeva, njehsorët për TR-1 dhe TR-2, duke përfshirë edhe njehsorët e linjës interkonektive LP 205/2, këmbimi i energjisë elektrike me Serbi.
- NS Berivojca, njehsorët e linjës interkonektive LP 1140/2, këmbimi i energjisë elektrike me Serbi.



Infrastruktura Telekomunikuese

Në Qershor të vitit 2011 është bërë komisionimi i projektit shumë të rëndësishëm për monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin e sistemit elektroenergjetik, i njohur si SCADA/EMS dhe Sistemi i Telekomunikacionit . Përmes këtij projekti janë plotësuar këto kushte:

- Një infrastrukturë unike telekomunikuese e cila më lehtë interkonektohet dhe menaxhohet,
- Janë lidhë po thuajse të gjitha objektet elektroenergjetike 400kV, 220kV dhe 110kV në rrjetin „backbone“ fiber optike.

Shtirja gjeografike e Fibrës Optikë në rrjetin transmetues të Kosovës është dhënë në fig.24.



Fig. 24 Shtirja gjeografike e Fibrës Optikë në rrjetin Transmetues në Kosovë

Përmes implementimit të paisjeve telekomunikuese të bazuar në teknologjinë SDH, janë realizuar 4 unaza SDH „backbone“ me siguri të dyfishtë (ring protection), për të siguruar rrjedhjen e informatave edhe në raste të defekteve të njëfishta.




Fig. 25 Arkitektura logjike e funksionimit të rrjetit telekomunikues

Siguria e dyfishtë e rrugëve komunikuese ngritë besueshmërinë e funksionimit të SCADA/EMS, me ç'rast mundësohet të ngritet besueshmëria e operimit me sistemin e transmisionit të KOSTT.

Me ndihmën e interfajseve TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohësisht duke zvogluar koston e shfrytëzimit të tyre. KOSTT po ashtu me ndihmën e interfajseve TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, ka mundësuar integrimin e trafostacioneve në rrjetet lokale kompjuterike të KOSTT.

Me ndihmën e interfajseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i pothuajse të gjitha objekteve elektroenergjetike në rrjetin lokal telefonik të KOSTT – VOIP (Voice over IP).

Për monitorimin në kohë reale të infrastruktures telekomunikuese – NMS (Network Management System) janë implementu dy qendra për menaxhim, Qendra kryesore në KCS dhe Qendra rezervë në EKCS.

Janë krijuar kushtet e interkonektimit me fije optike me TSO-të fqinje për komunikime inter-TSO.

Sistemi për Monitorim në kohë reale - SCADA EMS

Deri në përfundimin e komisionimit të projektit SCADA/EMS, KOSTT-i ka përdorur sistemin e përbërë nga SCADA dhe AGC të cilët kanë punuar në dy stacione punuese të pavarura. Në stacionin punues të SCADA është shfrytëzuar vetëm modi monitorues i punës dhe atë vetëm për matje analoge të linjave interkonektive për NS Kosova A, NS Kosova B, NS Podujeva dhe NS Prizreni 2. Alarmet, ngjarjet, gjendja e pajisjeve shkyçëse dhe komandimi nuk kanë qenë të realizuara në këtë stacion punues. Në stacionin punues për AGC është vëzhguar devijimi ndaj interkoneksionit si dhe monitoruar po ashtu të dhënat analoge sikurse në stacionin punues të SCADA.

Mundësitë e kufizuara të këtyre stacioneve punuese në aspektin e realizimit të SCADA/EMS funksioneve të përshkruara në rregullat nga ENTSO–E(UCTE) si dhe detyrimet nga kodi i operimit të rrjetit, mungesa e redundancës së pajisjeve të SCADA-së dhe EMS-it si dhe mungesa e pajisjeve të SCADA/EMS në qendrën emergjente e kanë detyru KOSTT-in që të realizoj sistemin SCADA/EMS si tërësi. Projekti “SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni” LOT 1 ka pasur për detyrë të realizoj:




Fig. 26 Principi i menaxhimit të rrjetit telekomunikues

- SCADA/EMS në qendrën Kryesore kontrolluese e cila përfshin edhe DTS me PDS;
- SCADA/EMS në Qendrën Emergjente kontrolluese;
- 26 RTU të reja në nënstacione 110/X kV duke përfshirë RTU lokale në QKK dhe QEK si dhe RTU për trajnime;
- 5 qendra meteorologjike të destinuara për parashikim të konsumit;
- Sistemin e SCADA lokale në nënstacion dhe Mbrojtje rele në NS Prizreni 2;
- Ndërlidhjen e 11 nënstacioneve me SCADA ekzistuese me SCADA/EMS në QKK dhe QEK përmes protokollit IEC 60870-4-104.

SCADA/EMS sistemi në QKK dhe QEK është i pajisur me 8 porte komunikuese për ndërlidhje me TSO fqinje përmes protokollit ICCP TASE 2.

Dizajni i sistemit SCADA/EMS është paraqitur në Fig.27:




Fig.27 Dizajni i sistemit SCADA/EMS


Funksionet të cilat realizohen përmes SCADA/EMS sistemit janë:

- Funksionet në SCADA përfshijnë grumbullimin e të dhënave në kohën reale (matje analoge, alarmet dhe ngjarjet) dhe komandimi me pajisje në çdo NS nga QKK apo QEK;
- Funksionet për menaxhimin e sistemit përmes veglave të mundësuar nga EMS janë:
 - Përpunuesi i gjendjes së Rjetit (Network Status Processor);
 - Parashikuesi i gjendjes (State Estimator);
 - Parashikimi i Ngarkesës (Bus Load Forecasting);
 - Përzgjedhja dhe analiza kontingjave (Contingency Selection and Analysis);
 - Llogaritja e rrymave të lidhjeve të shkurtëra (Short Circuit Level Calculation);
 - Rrjedhat e fuqisë (Operator Load Flow);

- Reduktimi i ngarkesës dhe Restaurimi (Load Shedding and Restoration);
- Kontrolla Automatike e gjenerimit (Automatic Generation Control);
- Optimizimi i rrjedhave të fuqisë (Optimal Power Flow);
- Dispeçimi i tensionit/ fuqisë reaktive
- Planifikimi i Operimit (Scheduling and Operational Planning).

- DTS sistemi për trajnime të dispeçerëve dhe për simulime;
- PDS sistemi për zhvillimin dhe sendërtimin e SCADA/EMS sistemit.
- HIS sistemi për ruajtjen e të dhënave në kohë reale për qëllim të raporteve të ndryshme nga të dhënat e arkivuara.
- ICCP TASE 2 sistemit i cili shërben për shkëmbimin e të dhënave në kohën reale me TSO fqinje dhe tjera në bazë të protokollit ICCP TASE 2.


Me sistemin SCADA/EMS është bërë e mundur vizualizimi i përgjithshëm i sistemit elektroenergjetik të Kosovës si në fig vijuese:



Në këtë vizuelizim shihen gjendja e pajisjeve dhe rrjedhat e fuqisë, tensionet, rrymat etj.

Për parashikimin e ngarkesës sistemi SCADA/EMS ka 5 stacione meteorologjike të shpërndara në Kosovë si në figurën vijuese:

Sistemi SCADA/EMS ka vetë monitorim. Serverat dhe rrjeta informative të cilat e sendërtojnë këtë sistem të përbërë janë dhënë në figurën vijuese:



Operimi i Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë

Tregu i energjisë në Kosovë operohet dhe administrohet nga Operatori i Tregut në kuadër të KOSTT, i cili është i licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Palët në treg të licencuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për aktivitete/role të caktuara janë nënshkruese të marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut dhe kështu obligohen të veprojnë në harmoni me këto rregulla. Në vitin 2010 palë aktive në treg kanë qenë 26 derisa në vitin 2011 kanë qenë gjithsej 22 palë të licencuara për të operuar në Tregun e Energjisë në Kosovë.

VITI	2010	2011
	Gwh	Gwh
Prodhimi i rregulluar	5010	5235
Prodhimi i kontraktuar	150	97
Importi i kontraktuar	818	816
Gjithsej Prodhimi + importi	5978	6148
Tregu (Konsumi) jo Tarifor	621	597
Konsumi i gjenerimit nga transmisioni	314	407
Tregu (Konsumi) Tarifor	4564	4630
Gjithsej Bruto Konsumi (me HC distributive)	5499	5634
Humbjet në transmision	131	115
Eksporti	352	371

Tab. 8 Transaksionet në tregun me shumicë

Modeli ekzistues i tregut të Kosovës bazohet në kontrata bilaterale për shitblerje të energjisë elektrike në mes palëve.

Në tabelën 8 janë paraqitur informata rreth transaksioneve në tregun me shumicë. Pjesa më e madhe e tregut të Kosovës është treg i rregulluar. Devijimet e sistemit ndaj sistemeve tjera nuk janë prezantuar prandaj shumatat nuk balancohen.

Në Tab. 8 është paraqitur madhësia e tregut, që i referohet konsumit tarifor dhe atij jo tarifor. Në konsumin e përgjithshëm është përfshirë edhe prodhimi i HC Lumbardhi i cili është i kyçur në rrjetin e shpërndarjes. Konsumi tarifor në periudhën Janar-Dhjetor 2010 ishte mesatarisht rreth 83% të konsumit të përgjithshëm bruto, kurse për periudhën Janar-Dhjetor 2011 ishte mesatarisht rreth 82% të konsumit të përgjithshëm bruto.




Fig. 28 Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jotarifor për vitin 2010/2011

Rrjedhat e energjisë elektrike në linjat interkonektive të Kosovës diktohen nga konsumi vendor dhe nga transaksionet ndërkufitare të energjisë elektrike në region. Vlerat e rrjedhave totale vjetore të matura të energjisë elektrike për vitin 2010 dhe vitin 2011 nëpër linjat interkonektive të Kosovës, në të dy kahet janë paraqitur në fig. 28.




Fig. 29 Rrjedhat vjetore të energjisë në interkoneksione për vitin 2010/2011

Viti 2011 krahasuar me 2010 ka pasur një kontinuitet përpos në muajin korrik ku në vitin 2011, krahasuar me korrikun e vitit 2010 vërehet një rritje e madhe e eksportit.





Fig.30 Krahasimi i prodhimit, konsumit, importit dhe eksportit për vitet 2010-2011

Energjia e importuar në vitin 2010 ka qenë 818,386 MWh dhe çmimi mesatar i importit të kontraktuar në këtë vit ishte 57.96€/MWh, derisa energjia e importuar gjatë vitit 2011 ka qenë 816,199 MWh dhe çmimi mesatar i importit të kontraktuar ishte 69.66€/MWh. Sasia e energjisë elektrike të importuar për 2011 krahasuar me vitin paraprak është zvogëluar për 0.26% kurse çmimi mesatar është rritur për 20.18%.

Energjia e eksportuar në vitin 2010 ka qenë 352,471 MWh dhe çmimi mesatar i eksportit 26.44€/MWh, derisa energjia e eksportuar gjatë vitit 2011 ka qenë 371,164 MWh dhe çmimi mesatar 45.05 €/MWh. Krahasuar me vitin 2010 sasija e energjisë elektrike të eksportuar për 2011 është rritur për 5.30% kurse çmimi mesatar është rritur për 70.38%.



Në fig. 29,30 dhe 31 janë paraqitur importi dhe eksporti mujor i energjisë elektrike, në MWh, për vitin 2010-2011 si dhe mesatarja e ponderuar e çmimit të importit të energjisë elektrike në nivelin me shumicë (wholesale), Janar '10 - Dhjetor '11 .



Fig. 31 Importi dhe eksporti në MWh sipas muajve të vitit 2010-2011






Fig. 32 Diagrami i çmimit mesatar të importit

Çmimi mesatar i energjisë elektrike në tregun e Kosovës për vitin 2010 është 24.15 €/MWh, ndërsa për vitin 2011 është 30.27 €/MWh.

Tranziti i energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit të KOSTT për vitin 2010 ka qenë 2626 GWh kurse për 2011 ka qenë 2192 GWh, pra ka pasur një rënie prej 16.52%.





Fig. 33 Tranziti i energjisë elektrike në rrjetin horizontal të Kosovës 2010/2011

Zhvillimet e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë

Zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike në përgjithësi, e në veçanti në Evropë, drejt reformimit të sektorit të energjisë elektrike dhe krijimit të tregjeve konkurruese doemos kanë pasur efekte edhe në reformimin e sektorit të energjisë elektrike në Kosovë.

Komisioni Evropian, si pjesë e projektit të tij për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike dhe themelimin e një tregu Evropian të vetëm të përbashkët të energjisë elektrike, ka ndërmarrë një iniciativë që të mbështesë vendet e regjionit të Evropës Juglindore (EJL) në harmonizimin e politikave të tyre nacionale të energjisë dhe zhvillimin e bazës ligjore në harmoni me direktivat Evropiane me qëllim kryesor që të:

- Tërheq dhe mbështes investimet në sektorin e energjisë elektrike;
- Përmirësoj sigurinë e furnizimit dhe
- Përkrah rritjen ekonomike.

Duke pasur parasysh:

- Objektivat që dalin nga strategjia e energjisë së Kosovës
- mungesën historike të investimeve në rrjet
- varësinë nga importet me çmime të larta
- mungesën e kapaciteteve prodhuese për të përmbushur kërkesën në rritje
- nivelin e lartë të humbjeve jo-teknike dhe mbi të gjitha pozitën e dobët financiare të pjesëmarrësve kryesorë në treg është paraqitur nevoja e zhvillimit të një tregu të përkohshëm i cili megjithatë do të jetë atraktiv për investitorët privat në prodhimin e energjisë elektrike.

KOSTT ka iniciuar procesin e modifikimit të modelit ekzistues të tregut të energjisë elektrike në Kosovë për të krijuar një dizajn të ri të tregut dhe kalimin nga faza ekzistuese e tregut të energjisë në një fazë më të avancuar.

Në shtator të vitit 2010 KOSTT është ngarkuar me detyrën për dizajnimin e tregut nga Ministria e Energjisë dhe Minierave. Në bazë të Termave të Referencës të miratuara nga MEM është themeluar Grupi Punues Teknik për hartimin e modelit të tregut në përbërje të MEM, MEF, ZRrE, Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT), Operatori i Tregut (KOSTT) i kryesuar nga KOSTT.

Sipas DTEEK parashihet që në Kosovë të themelohet një treg bilateral në të cilin pjesëmarrësit e licencuar do të blejnë dhe shesin energji elektrike. Sipas DTEEK tregu do të përcjellët me një mekanizëm balancues në të cilin OST pranon oferta për blerje dhe shitje të energjisë për të balancuar sistemin në kohën reale.

Drafti final i DTEEK i është dorëzuar ZRrE-së për aprovim në gusht të vitit 2011. Ndërkohë Operatori i Tregut ka filluar me procesin e modifikimit të Rregullave të Tregut bazuar në Dizajnin e Tregut të energjisë elektrike në mënyrë që të mundësoj implementimin e tij. Procesi pritet të përfundojë gjatë vitit 2012.

Gjatë vitit 2011 është instaluar dhe vënë pjesërisht në funk-

sion Platforma e Tregut e cila përfshinë funksionet e përshkruara në Rregullat e Tregut dhe e njëjta pritet që më vonë të shfrytëzohet nga palët në treg përmes infrastrukturës së internetit. Kjo platformë do të mundësoj komunikim të avancuar të Operatorit të Tregut me palët në treg dhe barazimin përfundimtar të tregtimeve ndërmjet palëve.

Bashkëpunimi dhe integrimi i KOSTT-it në asociacionet dhe mekanizmat regjional

Një ndër objektivat e rëndësishme të KOSTT është integrimi regjional. Përkundër angazhimeve të vazhdueshme të Operatorit të Tregut në këtë drejtim, KOSTT vazhdon edhe më tutje të ballafaqohet me shumë pengesa drejt integritit të KOSTT-it në mekanizmat regjional.



KOSTT është:

1. Vëzhgues në RG SEE
 - a. Vëzhgues në SG CMMI
2. Anëtar i CAO IG
3. Anëtar i PSC

Kosova si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, përmes KOSTT duhet të përmbush obligimet që dalin nga Rregullorja 1228/2003 që kanë të bëjnë me tregtimin ndërkufitar dhe në veçanti me transitin e energjisë elektrike dhe alokimin e kapaciteteve interkonjektive.

Transiti i energjisë elektrike - TSO-të kompensohen nga palët tregtare për shërbimin që u bëjnë atyre për transitin e energjisë elektrike në rrjetin e tyre elektrik. Të hyrat nga kompensimi i transimit shfrytëzohen për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmisionit të shkaktuara nga transiti si dhe mirëmbajtjen e rrjetit e transmisionit. Forma e kompensimit të transimit nëpër rrjetin e transmisionit të Kosovës deri në qershor të vitit 2004 ka qenë e rregulluar me marrëveshjen e përkohshme TEEA. Nga korriku 2004 deri në mars 2011 kompensimi bëhet në bazë të mekanizmit ITC (Inter TSO Compensation) bazuar në marrëveshje vullnetare mes TSO-ve të EJM, ku TSO-të kompensohen nga fondi përbashkët i krijuar për ITC. KOSTT me gjithë shprehjen e vullnetit dhe insistimit për të qenë nënshkruer i marrëveshjes është lënë jashtë për shkak të obstrukcioneve nga pala Serbe.

Në bazë të Rregullores të KE (Komisionit Evropian) nga marsi 2011 kompensimi duhet të bëhet jo sipas marrëveshjes vullnetare ndërmjet TSO-ve por në bazë të rregullores 838/2010 të KE e cila është obliguese për të gjitha TSO-të, përfshirë edhe KOSTT. Fatkeqësisht edhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, përkundër kërkesave për përfshirje, KOSTT është lënë jashtë mekanizmit të ITC. EMS është duke përfutur në mënyrë të kundërligjshme nga transiti i energjisë nëpër rrjetin e transmisionit të KOSTT me pretekst se rrjeti transmisionit në territorin e Kosovës është pjesë e rrjetit të EMS.

Alokimi i kapaciteteve Interkonjektive

Alokimi i kapaciteteve interkonjektive është një nga mënyrat e menaxhimit të kongjestionit (ngulftajtes) dhe bëhet në kufijtë e zonës tregtuese me zonat tjera duke aplikuar parimet e tregut për mos -diskriminim dhe transparencë. Edhe pse KOSTT si TSO e Kosovës, palë nënshkruese e Traktatit për Komunitetin e Energjisë, duhet t'i përmbushë obligimet që dalin nga Rregullorja

1228/2003 e KE për menaxhimin e kongjestionëve nuk është duke bërë alokimin e kapaciteteve të tij interkonjektive për shkak të obstrukcioneve nga pala Serbe.

Që nga viti 2006 EMS në mënyrë të kundërligjshme dhe pa autorizim apo marrëveshje me KOSTT alokon kapacitetet interkonjektive të KOSTT duke i shkaktuar kështu dëme financiare KOSTT-it.

Në harmoni me kërkesat ligjore lidhur me implementimin e ankandit të koordinuar për alokimin e kapaciteteve dhe duke i paraprirë vendimit për definimin e "regjionit të 8-të", Komuniteti i Energjisë ka iniciuar procesin për themelimin e CAOs (zyra regjionale për alokim të koordinuar). Siç është cekur më lartë, fillimisht në bazë të konkluzave të Forumit të Athinës, është themeluar Grupi Implementues (IG) i CAOs, i cili ka për qëllim përgatitjen e bazës ligjore dhe gjithë dokumentacionit të nevojshëm për themelimin dhe funksionalizimin e zyrës. Themelimi i CAO mund të konsiderohet si një proces kyç për zgjidhjen e problemit të alokimit të kapaciteteve të KOSTT.

Kontesti KOSTT - EMS. Që nga viti 2004 kur ka filluar implementimi i mekanizmit të ITC Serbia i ndërpret KEK-ut pagesat për transitin e energjisë elektrike fillojnë negociatat me palën Serbe për zgjidhjen e problemeve. Në këto negociata janë përfshi KEK-u, KOSTT-i (pas shthurjes së KEK-ut), ZRrE, UNMIK dhe MEM. Në pamundësi të arritjes së një marrëveshje me palën Serbe dhe EMS si TSO e sajë, KOSTT në Gusht të 2008 ka ngritur ankesë në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë ndaj Serbisë si palë nënshkruese e Traktatit, që njihet si kontesti "Case-3/8", lidhur me mospërmbushjen (shkeljen) nga ana e Serbisë të obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (ECS) respektivisht neneve 3 dhe 6 të rregullores 1228/2003 që kanë të bëjnë me kompensimin e transimit të energjisë elektrike dhe alokimit të kapaciteteve transmetuese interkonjektive.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) në përputhje me procedurat për zgjidhjen e kontesteve ka ndërmjetësuar disa takime mes KOSTT dhe palës Serbe (përfaqësuar nga MEM e Serbisë dhe EMS) për të shqyrtuar mundësinë e zgjidhjes së kontestit dhe arritjes së një marrëveshjeje bilaterale mes KOSTT dhe EMS. Këto takime kanë përfunduar pa arritjen e ndonjë marrëveshjeje pasi që EMS pretendon të jetë pronar i aseteve transmetuese të KOSTT.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i ka dërguar letër të hapur Republikës së Serbisë në shtator të vitit 2010 me vlerësim preliminar se Serbia ka bërë shkelje të provizioneve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Me datën 7 Tetor 2011 Sekretariati paraqet një gjykim të arsyeshëm në lidhje me rastin "Case-3/8", që Serbia përmes Operatorit të Sistemit të Transmisionit - EMS është duke bërë shkelje të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, respektivisht neneve 3 dhe 6 të rregullores 1228/2003 që kanë të bëjnë me kompensimin e transitit të energjisë elektrike dhe alokimit të kapaciteteve transmetuese interkonektive. Pritet që Sekretariati ta procedoj rastin në nivel të Këshillit të Ministrave me një rekomandim përcjellës që pritet të jetë në favor të KOSTT.

Siguria e Sistemit, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Siguria

Korniza ligjore për fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në punë është e rregulluar nga Ligji për Siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe Ambientit të punës; Ligjit për Mbrojtjen nga zjarri si dhe kodit të rrejtë. KOSTT ka mandat ligjor që të udhëheqë zhvillimin e sigurisë dhe për zbatim më praktik të legjislacionit primar dhe sekondar KOSTT ka nxjerrë edhe dokumente të brendshme për rregullimin, informimin dhe monitorimin mbi zbatimin e masave të sigurisë.

Ruajtja e shëndetit dhe mbrojtja në punë e punëtorëve, siguria e vendit të punës, mjedisit, pajisjeve dhe objektit kanë qenë, janë dhe do të jenë objektiva kryesore të Zyrës së SM përkatësisht Njësisë për SI dhe MKZ.

Aktiviteti i zyrës është zhvilluar në dy drejtime: në përmbushjen e masave preventive dhe përkrahjes dhe ngritjes profesionale të stafit.

Si pjesë e aktiviteteve preventive janë zhvilluar: kontrolli sistematik shëndetësor, furnizim me pajisje personale dhe mbrojtëse në punë, inspektimi në teren, instalimi i lajmërueseve nga zjarri, kontrollimi i aparateve zjarrfikëse etj.

Përkrahja dhe ngritja profesionale ka vazhduar me informimin e vazhdueshëm të stafit mbi masat e sigurisë, zhvillimit të trajnimeve, implementimit të projekteve dhe pjesëmarrjes në zhvillimet e gjithëmbarshme në KOSTT. Bashkëpunimi me palët e interesit etj.

Realizimi i njëkohshëm i shumë aktiviteteve gjithë andej rrejtë transmetues kishte për kërkesë operime të shumta dhe kujdes maksimal të QND, stafit të mirëmbajtjes dhe implementimit të projekteve. Kjo është arritur me nivelin më të lartë të sigurisë duke vepruar konform rregulloreve dhe procedurave për siguri në punë dhe masave preventive nga stafi i zyrës së sigurisë. Kjo ka qenë një sfidë e cila është kurorëzuar me zero incidente apo lëndime në punë i cili ishte dhe do të jetë caku i vetëm.

Për një nivel më të lartë jemi në implementim të projektit sipas IPA programit Zhvillimi dhe avancimi i dokumentacionit për siguri në punë dhe mbrojtje të punëtorëve, i cili shkon drejtë synimeve për certifikim me standardin për siguri OHSAS 18001, duke përmbushur standardet më të larta për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e stafit tonë dhe partnerët tanë nën kontratë.

Mjedisi

Gjatë vitit 2010-2011 aktivitetet Mjedisore në KOSTT janë orientuar në zhvillimin e vazhdueshëm mjedisor dhe ndërtimin kualitativ të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor (SMM), bazuar në udhëzimet e standardit përkatës. KOSTT është duke planifikuar që në një të ardhme të afërt të licencohet (certifikohet) me Standardin ISO 14001 2004.

Në implementimin e projekteve kapitale KOSTT për çdo projekt të propozuar kryen edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, sipas ligjeve dhe normave në fuqi.

KOSTT në politikat e veta respekton dhe i kushton rëndësi të veçantë mbrojtjes së mjedisit, edhe pse KOSTT nuk llogaritet si ndonjë ndotës i madh, përveç ndryshimeve në pejsazh.

Kapitulli i IV

Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe zbatimi i ISO

Zhvillimi dhe Trajnimi 2010-2011

Për realizimin e misionit, vizionit dhe strategjisë, së kompanisë "Sektori për Zhvillim të Personelit dhe Trajnimeve" ka pasur një rol shumë të rëndësishëm gjatë vitit 2010 dhe 2011 duke zhvilluar procesin e trajnimeve.

Vlera e shpenzimeve për kurse, trajnime, pjesëmarrje në grupe punuese të Evropës juglindore, publikime dhe literaturë profesionale gjatë vitit 2010 ka qenë 121,739.02 € ndërsa në vitin 2011 është 81,919.03 €

|| Gjithsejtë në trajnime dhe grupe punuese në vitin 2010 i kanë kaluar 116 punëtorë dhe janë realizuar 387 ditë trajnime, kurse në vitin 2011 janë përfshirë 86 punëtorë dhe janë realizuar 355 ditë trajnime dhe pjesëmarrje në grupe punuese.

Aktivitetet kryesore të këtij sektori në fushën e trajnimeve gjatë vitit 2010 janë fokusuar në zhvillimin e shkathtësive menaxhuese po ashtu edhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale, ku janë përfshirë të gjithë punonjësit e KOSTT sipas kompetencave të tyre.

Në vitin 2010 KOSTT është angazhuar në zhvillimin e shkathtësive të punëtorëve të financave dhe kontabilitetit përmes trajnimeve për Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave Publike; "Analiza financiare, evaluimi dhe buxheti"; "Pagesat, Pagat dhe Pasqyrat Financiare". Është vazhduar me edukimin e vazhdueshëm profesional për Standarde të Kontabilitetit, përmes të cilit kontabilistët edhe financierët e KOSTT-it kanë përfituar nga parimet e përgjithshme të buxhetit, ekzekutimin e buxhetit, kontrollin mbi ekzekutimin, sistemi informativ, burimi i informatave dhe raporteve financiare; analizën e pagave, planifikimin, pagat e kthyera dhe ripagesat e tyre, përgatitja e bilancit të gjendjes dhe suksesit, si dhe të rrjedhjes së parasë.

Përkushtim i veçantë i është dhënë edhe trajnimit dhe zhvillimit të stafit nga ekipi i mirëmbajtjes së linjave, ngritja e kapacitetit të ekipit për mirëmbajtjen e linjave nga i cili kanë përfituar punëtorët ekipeve të mirëmbajtjes së linjave

duke filluar nga struktura metalike e shtyllave, testimi i materialeve, inspektimin, diagnostifikimin, dizajnimin dhe rehabilitimin e shtyllave metalike dhe betonit, procedurat e galvanizimit, konstruksionin edhe ngritjen e shtyllave, vendosjen e izolatorëve dhe tërheqjen e përçuesve në kushte të tensionit pa zbritjen e përçuesve dhe telave, sistemi dhe rregullat e mirëmbajtjes së rrjetit transmetues. etj.

Poashtu duhet të theksohet se gjatë vitit 2010 është investuar edhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të inxhinjerisë duke realizuar trajnimet; "Menaxhimi i Aseteve (Asset Management)", "Dizajnimi i Trafostacioneve (Substation design course)" ku janë ofruar njohuri të reja për pjesëmarrësit e KOSTT-it nga dizajnimi dhe projektimi për pajisjet primare të trafostacioneve, topologjia e trafostacioneve, sistemi i zbarrave të tensionit të lartë, mbrojtja dhe kontrolli, tokëzimi, furnizimi me pajisje ndihmëse, trajnim për pajisjet e mbrojtjeve rele, trajnim për parashikim të konsumit përmes të cilit janë mbuluar këto objektiva, planifikimi afatshkurtër; modeli i parashikimit të ngarkesës, konceptet themelore e-terra platformë, proceset dhe procedurat e krijimit të bazës së të dhënave, aplikimi i bazës së të dhënave, menaxhimi i bazës së të dhënave obligime këto që dalin nga kërkesat e ENTSO-E.

Ka vazhduar edhe këtë vit trajnimi INTER TSO Trajnimi në Qendrën Dispeçerike në Mal të Zi që është një nga kërkesat e ENTSO-E.

Zhvillimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të BNJ dhe zhvillimi i strategjisë së trajnimeve - metodologjia e analizës së nevojave për trajnime në plotësimin e nevojave të kompanisë, vlerësimi i performancës, dizajnimi i strukturës organizative, transferimi i shkathtësive në vendin e punës, vendosja e objektivave dhe indaktorëve real është arritur përmes trajnimit "Strategjia e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimi Organizativ".

Poashtu është insistuar në Zhvillimin e shkathtësive Menaxheriale dhe udhëheqëse (leadership)- Star Consulting International. Janë avancuar njohuritë në përcaktimin e objektivave të kontrollit të brendshëm: parandalimi dhe zbulimi i gabimeve, shkeljeve ligjore, ruajtja dhe përdorimi i drejtë i burimeve financiare, saktësia dhe plotësimi i informacionit financiar, aplikimi i standardeve të kontrollit, kufizimet e kontrollit të brendshëm përmes trajnimit për "Kontroll të brendshëm dhe Auditim të brendshëm" dhe pjesëmarrjes në Kongresin Botëror të Kontabilistëve dhe Auditorëve.

Kompania ka mundësuar vijimin dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe forume: "CIGRE", "EU Enregy Law, EU Energy Director", "European Electricity Ancillary Services & Grid Integration", pjesëmarrje të përfaqësuesve të kompanisë në grupet punuese të asociacioneve për energji të Evropës juglindore si ENTSO-E, SETSO, SECI, si dhe nëngrupet RG SEE, PTSC dhe CAO IG, CMMI, ECI Group, STM. Pjesëmarrje në forumin e 3 të organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë lidhur me shqyrtimin e Çështjeve Sociale, etj.

Gjithashtu gjatë vitit 2010 me qëllim të sjelljes së përvojave nga kompanitë e avancuara stafi ynë ka marrë pjesë në Udhëtimin studiues i organizuar nga konsorciumi Terna/IPA në Romë të Italisë ku janë përfshirë 8 inxhinierë dhe menaxherë.

Gjithashtu vlen të theksohet kursi trajnues për mbrojtje kundër zjarrit për punëtorët e OT gjithsej 40 i cili ka ndikuar në ngritjen e shkathtësive për Mjetet personale mbrojtëse për siguri në punë, Shkaktarët që rrezikojnë sigurinë, shëndetin e të punësuarve në ambientin e punës, Veprimet për preventivën e mbrojtjes nga zjarri, Shkaktarët të cilët shkaktojnë zjarrin në ambientin industrial, Mjetet mbrojtëse kundër zjarrit, Përdorimi i aparateve për fikjen e zjarrit, Veprimi në rastet emergjente të shfaqjes së zjarrit.

Aktivitetet kryesore të këtij sektori në fushën e trajnimeve gjatë vitit 2011 janë fokusuar në programet zhvillimore për zhvillimin e shkathtësive profesionale të teknikëve të rinjë duke i përfshirë 10 teknikë në programin zhvillimorë me kohëzgjatje 44 ditë pune gjithsejtë 440 ditë trajnimi.

Gjatë vitit 2011 KOSTT-i është angazhuar në zhvillimin e shkathtësive të ndryshme të punëtorëve dhe shkathtësive në aplikacione të ndryshme si trajnimi Microsoft Project, trajnimi për Instrumentin e Para-Anëtarësimit (IPA); "Buxheti dhe sistemi i pagave sipas kornizës së re ligjore në Republikën e Kosovës"; Menaxhimi i Ciklit të Projektit", Marrëdhënia e Punës dhe Sistemi i Pagave, Shërbimet Publike dhe Kënaqësia e Konsumatorit, kursi i gjuhës an-

gleze; Euromoney Legal Training - Loan Documentation, Aspektet praktike të zbatimit të legjilacionit të ri nga marrëdhënia e punës dhe sistemi i pagave në Republikën e Kosovës, "Aplikimi i legjilacionit tatimor (TVSH, TAK dhe TAP) të institucionet, ndërrmarjet publike, Buxheti, Prokurimi Publik dhe Transparenca", Auditimi sipas standardeve ndërkombëtare, Parimet, Procedurat për menaxhimin zyrtar të dokumenteve dhe arkivimin e tyre; komercializimi i ndërrmarreve publike në sektorin e ujërave dhe energjisë si dhe rritja e performancës; trajnimin mbi krijimin e politikave për efikasitetin e energjisë.

Përkushtim i veçantë i është dhënë edhe trajnimit dhe zhvillimit të stafit nga ekipi i mirëmbajtjes dhe operimit duke implementuar trajnimet si vijon; trajnimin për qarqet ndërprerës SF6 tipi GL316 dhe GL311 F3 (110kV, 220kV dhe 420kV); trajnim për pajisje të mbrojtjes dhe kontrollit të TR3 Prizreni 2;

Po ashtu duhet të theksohet së gjatë vitit 2011 është investuar edhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të inxhinjerisë duke realizuar trajnim të avancuar për Softuerin DIGS14, "Shkëmbimi i të dhënave në mes të sistemeve të SCADA dhe pajisjeve të mbrojtjes"

Kompania ka mundësuar vijimin dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe forume si: "European Cross Border Power", "ENTSO-E Towards Electricity Infrastructure for a carbon Neutral Europe", SECI takimin e rregullt të rradhës së grupit regjional të Evropës Juglindore mbi planifikimin e rrjetit të transmisionit; "CIGRE"; RG SEE, PTSC dhe CAO IG, ENTSO-E, etj

Gjithashtu gjatë vitit 2011 me qëllim të sjelljes së përvojave nga kompanitë e avancuara në organizimin e Mbrojtjes dhe sigurisë së punëtorëve dhe klasifikimit të punëve sipas rrezikshmërisë, stafi ynë ka marrë pjesë në udhëtimin studiues i organizuar në kompaninë Terna/IPA në Romë të Italisë ku janë përfshirë punëtorët e zyrës për mbrojtje siguri dhe të departamentit të BNJ.

Në këtë aspekt vlen të theksohen kurset e realizuara gjatë vitit 2011 menaxhimi dhe programimi i sigurisë industriale dhe emergjencave, "Ndiqja e parë në vendin e punës" si dhe "Siguria industriale dhe mbrojtja kundër zjarrit".

Implementimi i projektit “Zbatimi praktik i menaxhimit të cilësisë bazuar ISO 9001:2008

Zbatimi Praktik i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008 si një detyrë komplekse e cila përveç angazhimit të menaxhmentit të KOSTT-it në veçanti ka angazhuar një ekip të udhëhequr nga menaxheri i Cilësisë.

Duke u bazuar në metodat që sigurojnë efikasitet maksimal ekipi i angazhuar ka zhvilluar dhe implementuar Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (SMC) për kompaninë KOSTT duke përfshirë edhe Auditimin e jashtëm certifikues.

Gjatë auditit është konstatuar se Sistemi i menaxhimit të Cilësisë (SMC) është harmonizuar me të gjitha kërkesat e standardit ISO 9001:2008 dhe ka rezultuar me certifikim të kompanisë me standardin ISO 9001:2008.

Teknologjia informative

Sot Teknologjia e Informacionit është e rëndësishë së posaçme jo vetëm për KOSTT por për tërë botën e biznesit dhe pa ndihmën e saj është e pamundur puna dhe realizimi i qëllimeve të kompanisë.


Për këtë qëllim KOSTT përmes Sektorit të TI në vazhdimësi ka realizuar projekte të cilat punëtorit i mundësojnë realizimin e këtyre caqeve të përcaktuara nga kompania. Projektet e implementuara ose ato në implementim janë të orientuara si në pajisjen e punëtorëve me harduer, softuer dhe projekte tjera.

Një projekt i cili është në implementim është Projekti i Aseteve i cili ka për qëllim të arritjes së

shfrytëzimit maksimal të aseteve në aspektin e kapaciteteve dhe besueshmërisë operative dhe njëkohësisht për të mbajtur koston operative të asetit në minimum prandaj është e domosdoshme përcjellja dhe kontrolli i avancuar i mirëmbajtjes së aseteve përmes sistemeve të kompjuterizuara për menaxhim dhe mirëmbajtje. Në këtë fazë Sektori i Teknologjisë së Informacionit i ka bërë përgatitjen e ToR për projektin: Dizajnimi, Zhvillimi dhe Implementimi i Aplikacionit Udhëheqja dhe Mirëmbajtja e Aseteve – UMA.

Ky projekt parashihet që të dizajnohet dhe zhvillohet gjatë vitit 2011 dhe pjesës së parë të vitit 2012 kurse implementimi i tij do të bëhet në pjesën e dytë të vitit 2012.

Sektori i teknologjisë së Informacionit gjithashtu është duke punuar në implementimin e moduleve të reja të cilat do të ndihmojnë në menaxhimin e punëve të departamenteve përkatëse në KOSTT si të BNU, Financave, Prokurimit etj.



Administrimi i personelit

Numri i të punësuarve në KOSTT	Viti 2010		Viti 2011		% (ritja)	
	214		241			12.61%
Struktura e të punësuarve sipas gjinisë	Viti 2010		Viti 2011			
Meshkuj	172	80.73%	193	80.08%		
Femra	42	19.62%	48	19.91%		
Struktura kualifikuese e punonjësve	Viti 2010		Viti 2011			
PSP (përgatitje superiore profesionale)	M	73	34.11%	M	81	33.60%
	F	27	12.61%	F	32	13.69%
PL (përgatitje e lartë)	M	3	1.40%	M	2	1.83%
	F			F		
KL (kualifikim i lartë)	M	14	6.54%	M	13	5.39%
	F			F		
PMP (përgatitje e mesme profesionale)	M	80	36.91%	M	96	39.83%
	F	11	5.14%	F	12	4.79%
PK (pa kualifikuar)	M	1	0.46%	M	1	0.41%
	F	4	1.87%	F	4	1.65%
KU (kualifikim i ulët)	M	1	0.46%	M		
	F			F		
Struktura sipas profesionit me PSP	Viti 2010		Viti 2011			
Inxhinier	78	36.44%	89	36.92%		
Ekonomist	14	6.54%	18	7.46%		
Jurist	6	2.80%	6	2.49%		
Fakulteti I Filologjisë/ Gjuhë Shqipe	2	0.93%	2	0.82%		
Mosha mesatare e të punësuarve	45 vite		44 vite			
Lëndime në punë	2 raste		1 raste			

Menaxhimi i resurseve njerëzore në KOSTT është i rregulluar me aktet e brendshme të kompanisë, përmes politikave dhe procedurave përkatëse.

Aktivitetet e menaxhimit të BNJ gjatë vitit 2010 janë zhvilluar mbi bazën e një Manuali të Punëtorëve, përmes përcaktimit të Politikave të veçanta si Politika e rekrutimit, Politika e pushimeve, Politika mbi pirjen e duhanit në vendin e punës, Politika mbi orientimin/njoftimin e punëtorëve të rinj, Politika për shpërblimet dhe mirënjohjet e punëtorëve, politika për orarin e punës etj.

KOSTT ka arritur të zhvilloj edhe më tej sistemin e bazës së të dhënave të personelit përmes moduleve të BNJ duke e avancuar punën, për një shërbim sa më cilësor dhe të shpejtë për punëtorët dhe çdoherë shkon në drejtim të zhvillimit të punës në përgjithësi.

Kujdesi ndaj punëtorëve

Kujdes të veçantë KOSTT i kushton shëndetit të punonjësve, prandaj për qëllim të kujdesit më të mirë ndaj shëndetit të punëtorëve të kompanisë tonë KOSTT ka implementuar sistemin suplementar të sigurimeve shëndetësore dhe aksidentale jashtë sistemit aktual shtetëror shëndetësor.

Menaxhimi i objekteve

Për qëllim të arritjes së objektivave të saj KOSTT gjithmonë është orientuar në krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë punëtorët e saj. Për këtë qëllim janë realizuar shumë projekte për krijimin e kushteve më të mira të punës dhe punëtorëve tanë do ti mundësojnë një vend pune në të cilën ata do të ndihen më mirë në realizimin e detyrave të tyre dhe arritjen e një performace më të mirë. Duke pasur parasysh këtë investimet janë bërë duke filluar prej rregullimit të zyrave dhe ambientit tjetër të punës në të gjitha objektet e KOSTT.

Në këtë drejtim një nga investimet më të rëndësishme është rregullimi i hapësirave të punës për Departamentin e Operatorit të Sistemit në kuadër të projektit SCADA/EMS, projekt në realizim në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare i cili pritet të lëshohet në punë në vitin 2011.

Gjithashtu është në përfundim realizimi i projektit „Renovimin e Garazhës” si dhe përgatitja e tij për implementim i cili parashihet të përfundoj gjatë vitit 2011 kështu duke krijuar hapësire të mjaftueshme për parkimin e automjeteve zyrtare të KOSTT.

Investimet për krijimin e kushteve më të mira për të gjithë punëtorët e saj në harmoni me standardet më të larta do të vazhdojnë të implementohen edhe në të ardhmen.

Përgjegjësia Shoqërore Korporative në KOSTT

Përgjegjësia Shoqërore Korporative (PShK) është pjesë e strategjisë së përgjithshme të funksionimit të KOSTT dhe parimet themelore të PShK-së për zhvillim të qëndrueshëm janë të integruara në misionin e KOSTT. Për më tepër, që nga vitit 2008 PShK është gjithashtu edhe pjesë përbërëse e Strategjisë së Komunikimit. KOSTT e konsideron PShK-në si një proces përmes së cilës kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm fillimisht përmes mënyrës se si operon duke inkorporuar politikat e biznesit të përgjegjshëm në politikat e brendshme të kompanisë. KOSTT gjithashtu kujdes i kushton zhvillimit dhe trajnimit të punonjësve dhe kërkesave mjedisore ndërkaq theks të veçantë i vë sigurisë së operimit të impianteve të veta për popullatën, të punësuarit e vet si dhe gjallesat tjera gjë që është esenciale për një kompani që ka të bëjë me energji elektrike të tensionit të lartë.

Në një ceremoni rasti organizuar me 3 mars 2011 nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, në mesin e tetë bizneseve të shquara në vend, Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT, iu nda mirënjohje për përpjekjet e vazhdueshme në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe përkrahjen e artistëve të Kosovës.

Më 21 Prill 2011 u themelua Rrjeti i Përgjegjësive Shoqërore të Korporatave (PShK) në Kosovë nga liderët e bizneseve të dalluara Kosovare dhe ndërkombëtare të cilët ishin të përkushtuar për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për PShK-në dhe të përfshijnë praktikatat më të mira të PShK-së në kompanitë e tyre. Në Asamblën e parë të Përgjithshme të mbajtur më 13 qershor 2011 anëtarët e rrjetit PShK zgjodhen pesë anëtarët e bordit ku në cilësinë e Sekretarit të Bordit është zgjedhur përfaqësuesi i KOSTT.

Në vazhden e përkrahjes së PShK-së, KOSTT ka zhvilluar dhe implementuar një iniciativë unike, përmes së cilës i ka shërbyer komunitetit, duke promovuar prodhimet vendore artizanale. Njëherit kjo iniciativë u dëshmuar edhe si shembull i mirë se si mjetet financiare të dedikuara për dhurata korporative mund të orientohen në promovimin e prodhimit vendorë dhe me këtë zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.



Pasqyra e ngjarjeve më të rëndësishme gjatë vitit 2010



Janar 2010

Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në Kosovë z. Peter Feith, në vizitën që e realizoi në KOSTT potencoi gatishmërinë për përkrahje në përpjekjet për avancimin e pozitës së Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës në rajon dhe Evropë: Njëkohësisht u shpreh i kënaqur me punën dhe menaxhimin e kësaj ndërmarrje publike duke e konsideruar si shembull të menaxhimit të mirë në Kosovë.

Në kuadër të Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave, KOSTT kontribuoi në tejkalimin e situatës së rëndë që kaploi disa vise të Republikës së Shqipërisë me vërshimet nga uji të shumë sipërfaqeve të tokës dhe shtëpive të banimit.



Shkurt 2010

Pas përfundimit të projektit për rehabilitimin e largpërçuesit LP 212, në shkurt 2010 u lëshua në punë largpërçuesi i tensionit të lartë 110 kV (kilovolt) që lidhë Nënstacionin 220/110 kV (kilovolt) Kosova A me Nënstacionin 110/35 kV Ferizaj 1 (Bibaj).



Mars 2010

KOSTT dhe Korporata Energjetike e Shqipërisë (KESH), në mars të vitit 2010, në Prishtinë, nënshkruan Marrëveshjen për Shërbime Ndihmëse. Marrëveshja për Shërbime Ndihmëse e cila u nënshkrua nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Fadil Ismajli dhe Drejtori Menaxhues i KESH z. Muharrem Stojku, parasheh blerjen e shërbimeve ndihmëse në rregullimin frekuencë-fuqi, nga gjeneratorët e KESH respektivisht nga gjeneratorët e Hidrocentralit të Fierzës. Marrëveshja është plotësisht në harmoni me standardet Evropiane respektivisht të Asociacionit të Operatorëve Evropian të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike ENTSO-E.



Prill 2010

Me 1 prill 2010, Parlamenti i Republikës së Kosovës me shumicë absolute të votave ratifikoi Marrëveshjen për Kredi dhe Financim të linjës interkonektive 400kV, Kosovë-Shqipëri. Marrëveshja parasheh një buxhet prej €33,5 mil. nga e cila €17,0 mil është kredi komerciale afatgjate me kushte kredituese të buta dhe €16,5 mil grant të Qeverisë Gjermane.

19 prill 2010, në Gjakovë u prezantua Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri me ç'rast qytetarët dhe palët e interesuara patën rastin që të drejtojnë pyetjet e tyre rreth çështjeve ambientale panelit i cili ishte në përbërje të përfaqësuesve të KOSTT dhe të MMPH.

Maj 2010

Në vazhdimësi të implementimit të Paket Projektit Peja 3, në maj të vitit 2010, u lëshua nën tension largpërçuesi i ri 110 kV (kilovolt) LP 1810 që lidhë Nën-stacionin 400/110 kV Peja 3 me NS 110/10 kV Klina.

Qershor 2010

Si pasojë e temperaturave të larta që kanë mbizotëruar, është shkaktuar sh-përthimi i transformatorit matës rrymor në Nënstacionin NS 220/110 kV Prishtina 4, transformatorë i cili daton që nga vitet e 80ta.

Ekipet e KOSTT sh.a kanë ndërmarrë masa të menjëhershme dhe kanë eliminuar efektet e kësaj ndodhie.

Edhe për vitin 2009, për të katërtën herë rradhazi, raporti i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare është pa asnjë kualifikim, që reflekton punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës.



Korrik 2010

Në takimin që realizoi Drejtori i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë z. Slavtcho Neykov me Kryeshefin e KOSTT z. Fadil Ismajli, z. Neykov theksoi rolin e rëndësishëm që kanë OST-të sidomos duke u bazuar në Pakon e 3-të të legjislacionit për energjinë elektrike të Bashkimit Evropian, si dhe potencoi rolin e KOSTT si shumë të rëndësishëm në zhvillimet e tregut të energjisë elektrike në nivel vendor dhe të kooperimit rajonal, si OST e Kosovës.

Në Korrik 2010 u instalua Autotransformatori i ri AT3 me fuqi 150 MVA (mega volt amper) në Nënstacionin NS 220/110 kV (kilovolt) Prishtina 4. Instalimi i Autotransformatorit të ri në Nënstacionin Prishtina 4 është bërë në përputhje me Planin Zhvillimor të Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007-2013 dhe financohet nga buxheti i KOSTT për investime kapitale. Projekti kap vlerën prej 2.845.000 Euro.



Gusht 2010

Në gusht 2010 u lëshua nën tension linja e re e dyfishtë e tensionit të lartë 110/35 kV (kilovolt) që lidhë Nënstacionin Skenderaj me Nënstacionin Peja 3 dhe me Nënstacionin Vallaç.

Shtator 2010

Me 27 shtator 2010 në Prishtinë, KOSTT sh.a organizoi Tryezë Pune ku u prezantua Studimi për Zgjerimin e Rrjetit Transmetues të Republikës së Kosovës. Objektivë kryesorë e studimit është ofrimi i udhëzimeve për modernizimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës. Financimin për realizimin e Studimit për “Zgjerimin e Rrjetit Transmetues” e ka bërë Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim KfW ndërkaq studimi është realizuar nga kompania konsulente gjermane FICHTNER.



Në shtator të vitit 2010 sekretariati i komunitetit të energjisë për Evropën juglindore hapi procedurën e kontestit ndaj Serbisë për shkelje të dispozitave të traktatit të komunitetit të energjisë për EJT, pas ankesës formale që kishte dorëzuar KOSTT në gusht të vitit 2008 (SKE nr. ECS.3/08)



Tetor 2010

Me 1 tetor 2010 në Ferizaj, nën organizimin e KOSTT sh.a dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, u mbajt Debat Publik për çështjet ambientale të projektit për ndërtimin e Nënstacionit të ri 400/110 kV Ferizaj 2 dhe linjave ndërlidhëse 400 kV dhe 110 kV (kilovolt), ku u prezantua Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis(VNM) të Paket Projektit Ferizaj 2.



Nëntor 2010

Pas auditimit të jashtëm të sistemit të menaxhimit të organizatës nga ana e Bureau Veritas, është vërtetuar konformiteti me kërkesat e Standardit dhe me këtë KOSTT sh.a bëhet kompania e parë publike në Kosovë e cila çertifikohet me Standardin ISO 9001:2008.

Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT z. Fadil Ismajli përcjelli punimet e “Forumit të parë për tregëti dhe Investime” organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Washington (SHBA). Prezantimi i z. Ismajlit në kuadër të sesionit për Enërgji të Formut, zgjoi interesim nga ana e pjesëmarrësve, të cilët KOSTT-in e cilësuan si një storie të sukseshme nga ana e të arriturve si dhe menaxhimit.

Dhjetor 2010

Në muajin dhjetor, KOSTT ka zhvilluar dhe implementuar një iniciative unike, përmes së cilës i ka shërbyer komunitetit, duke promovuar trashëgiminë kulturore dhe njëkohësisht komunikuar me palët e interesit. Njëherit kjo iniciativë u dëshmuar edhe si shembull i mirë se si mjetet financiare të dedikuara për dhurata korporative mund të orientohen në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe me këtë zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Pasqyra ngjarjeve më të rëndësishme gjatë vitit 2011



Mars 2011

Në një ceremoni rasti organizuar me 3 mars 2011 nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, në mesin e tetë bizneseve të shquara në vend, Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT, iu nda mirënjohje për përpjekjet e vazhdueshme në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe përkrahjen e artistëve të Kosovës.

KOSTT ka marrë pjesë në kuadër të delegacionit shtetëror të Kosovës, dhe është përfaqësuar me një prezantim në Samitin e Biznesit SHBA – Ballkan, të mbajtur me 23-24 mars.

Prill 2011

Gjate muajit prill vazhdoi intensivisht testimi i pajisjeve te nenstacioneve ne kuader te projektit SCADA/EMS. Me projektin e KOSTT për instalimin e sistemit komandues dhe monitorues - SCADA/EMS dhe Telekomit, do të rritet siguria dhe besueshmëria e Sistemit Elektroenergjetik (SEE) të Republikës së Kosovës duke automatizuar sistemin elektrik si dhe do të mundësohet komandimi, monitorimi dhe në përgjithësi menaxhimi më efikas i SEE nga Qendra Dispeçerike Nacionale në KOSTT.





Maj 2011

Me 4 maj 2011, në një ceremoni solemne në Nënstacionin 400/220 kV Kosova B në Kastriot, Kryeministri i Republikës së Kosovës z.Hashim Thaçi dhe Ministri për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim i Republikës Federale të Gjermanisë, z.Dirk Niebel vunë gurthemelin në pikënisjen e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri. Projekti për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri është projekti i dytë kapital në Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës, i cili financohet nga Qeveria Gjermane përmes Bankës për Zhvillim-KfW, pas Paket Projektit Peja 3 i cili u bashkëfinancua nga Qeveria Gjermane dhe Qeveria e Kosovës.



Me 26 maj 2011, KOSTT ka lansuar faqen e ri-dizajnuar elektronike me një pamje krejtësisht të re dhe më dinamike. Me këtë, faqja elektronike e KOSTT u ofron palëve të interesuara sistem më të përshtatshëm të navigimit dhe qasje më të lehtë deri tek informatat me interes.

Qershor 2011

Me 2 qershor 2011, Policia e Kosovës ka parandaluar me sukses vjedhjen e konstruksioneve metalike të shtyllave nr. 08 dhe nr.09 të linjave elektrike të tensionit të lartë 110 kV LP 1807 dhe LP 1808 të cilat lidhin Nënstacionet NS 220/110 kV Kosova A me NS 110/10 (20) kV Prishtina 5. Me këtë rast njesitë e Policisë së Kosovës (PK)-së kanë arrestuar 2 persona në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë në fshatin Shkabaj tek të cilët janë gjetur mbi 70 profile metalike të shtyllave si dhe 148 bulona. Materialet e konfiskuara i janë kthyer KOSTT-it dhe ekipet e KOSTT kanë filluar menjëherë me montimin dhe sanimin e dëmeve të shkaktuara.

Me 30 qershor 2011 në Vjenë është mbajtur takimi për ditët e Kosovës në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, ku janë prezantuar arritjet e Kosovës karshi obligimeve që dalin nga Traktati. Me kërkesë të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik në takim ka marrë pjesë edhe KOSTT, ku është prezantuar puna lidhur me hartimin e modelit të tregut.

Auditori i Jashtëm ka dorëzuar raportin final për auditimin e vitit fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2010, dhe sikurse edhe vitet paraprake ky raport nuk përmban asnjë kualifikim, e që dëshmon vazhdimësinë e praktikave të mira





Korrik 2011

Me 1 korrik 2011, me rastin e 5 vjetorit të themelimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës-KOSTT, z.Besim Beqaj Ministër i Zhvillim Ekonomik, z. Jean Francois Fitou Ambasador i Republikës së Francës në Kosovë dhe z.Fadil Ismajli Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT, inauguruan projektin kapital të sistemit komandues dhe monitorues të Sistemit Elektroenergjetik: SCADA/EMS dhe Telekom. Projekti kapital për instalimin e sistemit komandues dhe monitorues të Sistemit Elektroenergjetik: SCADA/EMS dhe Telekom, në vlerë prej 18 milion Euro, është financuar plotësisht nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ndërkaq është implementuar nga konzorciumi Alstom (ish-Areva)/Komtel Project Engineering (Francë/Kosovë) për pjesën SCADA/EMS dhe konzorciumi Energoinvest/Alstom (ish-Areva) (BH/Francë) për pjesën e Rrjetit Telekomunikues.

Me 4 korrik 2011, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a shenoi 5 vjetorin e themelimit. Në ceremoninë zyrtare të organizuar me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli falënderoi punonjësit e KOSTT për angazhimin dhe përkushtimin e pakursyer.Gjithashtu u prezantua edhe filmi i shkurtër dokumentar KOSTT-5 Vite të Suksesshme.Të pranishmëve i'u drejtua me një fjalë rasti ministri i Zhvillimit Ekonomik z.Besim Beqaj dhe z.Chris Hall president i Universitetit Amerikan të Kosovës, ndërkaq zv.Kryeministri i Kosovës z.Behxhet Pacolli në pa mundësi të pjesëmarrjes ka dërguar një fjalim i cili u lexua para të pranishmëve.

Gusht 2011

Me 15 gusht 2011 filloi realizimin i projektit "Ndërrimi i izolatorëve, përçuesve dhe pajisjeve lidhëse për linjë 110 kV -125/2 (Vushtrri 1-Trepçë) dhe linjën 110 kV - 125/3 (Trepçë- Vallaç)".

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 10/29 e datës 3 Gusht 2011 ka vendosur që asetet 400/220/110 kV dhe transformatorët 220/35/10(20) dhe 110/xkV si dhe fushat përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10(20) kV të transferohen nga KEK sh.a në KOSTT sh.a.



Tetor 2011

Në fillim të tetorit në bazë ankesë së KOSTT, SKE ka dorëzuar "Reasoned Opinion/Mendim i bazuar" në të cilin konkludon se Republika e Serbisë, përmes EMS (OST e Serbisë) ka dështuar në implementimin/respektimin e Nenit 3 dhe 6 të Rregullores së KE-së 1228/2003 për kushtet e qasjes në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike. Kjo ka të bëjë me moskompensimin e KOSTT si Operator i Sistemit të Transmisionit të Kosovës.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, i ka dhënë Serbisë afat 2 muaj që të korrigojë shkeljet e identifikuar. Sipas Aktit Procedural të SKE no.2008/01/MC-EnC, varësisht nga përgjigjja apo mospërgjigjja e Serbisë, SKE mund ta dërgoj kërkesën me propozimin për vendim në Këshillin e Ministrave.

Me 18 tetor pas punës dhe angazhimit maksimal u finalizua Paketë Projekti Ferizaj 2, si dhe u bë energjizimi me sukses i objekteve Ns 400/110/10 kV - Ferizaj 2, 300 MVA dhe linjat ndërlidhëse 400 1KV, 110 kV dhe 10 kV

Me 21 tetor 2011 z.Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT dhe Drejtori Gjeneral i Operatorit të Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Maqedonisë (MEPSO) z.Dejan Boshkovski, në Shkup nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) i cili shpreh vullnetin e palëve për avansimin e bashkëpunimit në lëmin e interkoneksionit. Më konkretisht, me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të KOSTT dhe MEPSO krijohen parakushtet për fillimin e një seti të veprimeve që do ti paraprijnë realizimit të projektit të planifikuar për ndërtimin e linjës së re interkonektive 400 kV në mes të Kosovës dhe Maqedonisë linjë e cila paraqet rëndësi të madhe si në aspektin bilateral ashtu edhe në atë rajonal.



Nëntor 2011

Me datë 23 nëntor 2011 u lëshua në punë provuese Nënstacioni NS 110/10 (20) kV Skenderaj, me autotransformator 31.5 MVA (mega volt amper), bashkë me linjën e dyfishtë 110 kV (kilovolt), që lidhë këtë nënstation me nënstationet tjera: NS 400/110 kV Peja 3 dhe NS 110/35 kV Vallaq. Projekti i KOSTT sh.a për zgjerimin e NS Skenderaj prej nivelit 35/10 (20) kV në atë 110/10(20) kV është në kuadër të Paket Projektit Peja 3, që është bashkëfinancim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes Buxhetit të Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Gjermanisë, përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW). Me këtë investim, rajoni i Skenderajt për herë të parë bëhet me linjë të tensionit të lartë 110 kV si dhe me Nënstacion 110 kV me transformim 31.5 MVA, që njëherit janë parakushte për mundësimin e zhvillimit ekonomik dhe industrial të këtij rajoni.

Dhjetor 2011

Në përkrahje të produkteve vendore KOSTT sh.a në fund të vitit 2011 ka implementuar projektin për mbështetjen e prodhimtarisë së vendit duke promovuar produktet vendore dhe njëkohësisht komunikuar me palët e interesit përmes dhuratave korporative.

KOSTT ka përkrahur disa prodhues vendor të produkteve me karakteristik siç janë punimet artizanale: Qilimet e punar me vekë, Stolitë e argjentit të punuara me teknikën e filigranit, mjaltë vendore 100 % natyrale dhe punime dore të drurit. Në mbështetje të kësaj iniciative KOSTT ka gjetuar përkrahjen e plotë nga e Odës Ekonomike të Kosovës si përfaqësuese e interesave të komunitetit të biznesit.



Kapitulli i V

Raportet e Auditorit 2010/2011



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Prishtine
Kosovo

Telephone +381(081) 246 771
Telefax +381 (38) 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve te pavarur

Bordit Drejtues të
Operatorit te Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT

Prishtine, 3 Qershor 2011

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Operatorit te Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT J.S.C ("Shoqeria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e gjendjes financiare e datës 31 dhjetor 2010, pasqyra përmbledhëse të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e rrjedhës së parave për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe kontrollin të brendshme të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasqje e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedurat të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmerinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.



Ne besojmë që evidencea e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin e auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare të Shoqërisë me 31 dhjetor 2010, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Cështje e theksuar

Pa kualifikuar raportin tonë, ne tërheqim vëmendjen të nota 23 (i) e pasqyrave financiare, ku ekziston një shkallë pasigurie për shlyerjen finale të shumave prej 4,215 mijë Euro të cilat janë detyrime ndaj Elektomreza Serbije dhe janë njohur në detyrime tregtare dhe detyrime të tjera, ndërsa faturat për të hyrat për shërbime ndaj Elektomreza Serbije, të cilat kanë arritur shumën prej 10,373 mijë Euro, nuk janë regjistruara në këto pasqyra financiare. Në të dy rastet zgjidhja përfundimtare është e varur nga negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Cështje tjetër

Pasqyrat financiare të Shoqërisë me dhe për vitin që përfundoi me 31 dhjetore 2009 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka dhënë një opinion të pa modifikuar me 13 maj 2010.

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Prishtina
Kosovo

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
Pasqyra e Pozicionit Financiar në 31 Dhjetor 2010
(në EUR)

	Shëni me	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
AKTIVI			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	88,791	75,195
Aktive afatgjata jo materiale	7	36	46
		<u>88,827</u>	<u>75,241</u>
Aktive afatshkurtra			
Inventarët	9	908	1,016
Të arkëtueshme dhe të tjera	10	9,390	10,202
Parapagime furnitorëve	8	6,887	8,502
Mjete monetare në arkë e bankë	11	14,850	9,137
		<u>32,035</u>	<u>28,857</u>
Totali i aktivit		<u>120,862</u>	<u>104,098</u>
KAPITALI			
Kapitali aksioner	12	25	25
Prim i aksioneve	12	28,347	28,347
Fitimi të bartura		10,617	3,853
Fitimi i periudhës		3,468	6,764
Totali i kapitalit		<u>42,457</u>	<u>38,989</u>
DETYRIME			
Detyrime afatgjata			
Grante qeveritare	13	68,392	57,362
		<u>68,392</u>	<u>57,362</u>
Detyrime afatshkurtra			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	14	8,671	7,097
Detyrim i tatimit të periudhës	21	157	481
Detyrim i tatimit të shtyrë		185	169
		<u>9,013</u>	<u>7,747</u>
Totali i detyrimeve		<u>78,405</u>	<u>65,109</u>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		<u>120,862</u>	<u>104,098</u>


Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve më 3 Prill 2011 dhe janë firmosur në emër të Bordit nga:

Kryeshkëqerues Ekzekutiv
Fadi Ismaili



Zyrtari kryesor financiar
Nebih Haziri



Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
Pasqyra e të ardhurave përmblëdhëse për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
(në EUR)

	Shëni me	2010	2009
Të ardhura			
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	15	20,076	20,061
Të ardhura të tjera	16	2,348	977
		<u>22,424</u>	<u>(21,038)</u>
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	17	(2,736)	(2,338)
Amortizimi dhe zhvleresimi	6,7	(4,866)	(3,001)
Riparime dhe mirëmbajtje	18	(752)	(918)
Humbje në transmisionin e energjisë		(4,319)	(5,212)
Shpenzimet e tjera operative	19	(4,121)	(1,258)
Rregullim dytësor		(1,600)	(996)
Shpenzime për lëndë djegëse		(190)	(79)
		<u>(18,584)</u>	<u>(13,802)</u>
Fitimi operativ		<u>(18,584)</u>	<u>(13,802)</u>
Të ardhura interesi	20	301	219
		<u>4,141</u>	<u>7,455</u>
Fitimi para tatimit		<u>4,141</u>	<u>7,455</u>
Tatimi mbi fitimin	21	(673)	691
		<u>3,468</u>	<u>6,764</u>
Fitimi neto i periudhës		<u>3,468</u>	<u>6,764</u>
Të ardhura të tjera përmblëdhëse, neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali i të ardhurave përmblëdhëse për vitin		<u>3,468</u>	<u>6,764</u>

Pasqyra e të ardhurave përmblëdhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit në 31 Dhjetor 2010
(në EUR)

	Kapitali aksionier	Prim i aksioneve	Fitime të mbartura	Totali
Gjendje në 1 Janar 2009	25	28,347	3,853	32,225
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	-	-
Fitimi për periudhën	-	-	6,764	6,764
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	6,764	6,764
Gjendja në 31 Dhjetor 2009	25	28,347	10,617	38,989
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	-	-
Fitimi për periudhën	-	-	3,468	3,468
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	3,468	3,468
Gjendja në 31 Dhjetor 2010	25	28,347	14,085	42,457

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
(në EUR)

	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Rrjedhja e parash nga aktivitetet operative			
Fitimi neto i periudhës		3,469	6,764
<i>Rregullime për të rrekonciliuar ndryshimet e aktiveve neto në para neto nga aktivitetet operative:</i>			
Amortizimi dhe zhvleresimi	6,7	4,886	3,001
Të ardhurat nga interesi	20	(301)	(219)
Nxjerrje nga përdorimi e aktiveve afatgjata materiale	6	8	18
Të ardhura të shtyra nga grantet		(1,828)	(890)
		<u>6,214</u>	<u>8,764</u>
Rrjedha e parash nga fitimi operativ para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative <i>(Rritje)/rënie në aktivet operative:</i>			
Inventarë		108	241
Të arkëtueshme dhe të tjera		812	(2,624)
Parapagime ndaj furnitorëve		1,615	2,001
Të pagueshme dhe të tjera		1,574	2,305
Detyrim i tatimit të periudhës		(324)	481
Detyrimi për tatimin e shtyrë		16	169
Rrjedha neto e parash nga aktivitetet operative		<u>10,015</u>	<u>11,247</u>
Rrjedha e parash nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	6,7	(18,460)	(34,904)
Interesi i marrë		301	219
Flukset neto të parash të përdorura në aktivitetet investuese		<u>(18,159)</u>	<u>(34,685)</u>
Rrjedha e parash nga aktivitetet financuese			
Grantet e pranuar (të arkëtueshme)		14,019	28,215
Grantet e kthyer (grantet e papërdorura)		(161)	-
Rrjedha neto e parash nga aktivitetet financuese		<u>13,858</u>	<u>28,215</u>
Rritja neto në mjete monetare në arkë e bankë		5,713	4,777
Mjete monetare në arkë e bankë në fillim të vitit		9,137	4,360
Mjete monetare në arkë e bankë në fund të vitit		<u>14,850</u>	<u>9,137</u>

Pasqyra e rrjedhes se parash duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.



Tel: +381 38 221 172
Fax: +381 38 221 170
www.bdo.com

BDO Kosova L.L.C.
Rr. Luan Haradinaj HS, Nr.7
10000 Prishtine Kosova

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për bordin e drejtorëve të KOSTT SH.A.

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, Sistemit "KOSTT SH.A." (më tej referuar si "Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2011, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parase për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për kualifikim të opinionit, ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2011 dhe performansën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parase për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

BDO Kosova L.L.C.

BDO Kosova L.L.C
Prishtina, Kosova
19 Mars 2012

BDO Kosova L.L.C. is a member of BDO International Limited, a UK company limited by guarantee, and forms part of the International BDO network of independent member firms.
BDO is the brand name for the BDO network and for each of the BDO member firms.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a. Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2011

Shënim	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)	
ASETET			
Asetet afatgjata			
Prona dhe pajisjet	4	94,102	88,791
Asetet e paprekshme	5	1,457	36
		<u>95,559</u>	<u>88,827</u>
Asetet afatshkurtra			
Stoqet	6	1,654	908
Të arkëtueshmet	7	7,590	9,281
Kërkesa tjera	8	3,191	6,996
Para nga dorë dhe në bankë	9	18,605	14,850
		<u>31,040</u>	<u>32,035</u>
TOTAL ASETET		<u>126,599</u>	<u>120,862</u>
EKUITETI DHE OBLIGIMET			
Ekuiteti			
Kapitali i pronarëve	10	25	25
Primi i aksioneve	11	28,347	28,347
Fitimet e mbajtura		14,085	10,617
Fitimi i vitit		1,283	3,468
		<u>43,740</u>	<u>42,457</u>
Obligimet afatgjata			
Grantet e shtyra	12	75,414	69,392
Obligimet afatshkurtra			
Obligimet tregtare dhe të tjera	13	7,445	9,013
		<u>82,859</u>	<u>78,405</u>
TOTAL EKUITETI DHE OBLIGIMET		<u>126,599</u>	<u>120,862</u>

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 19 Mars 2012.

Ztr. Fadil Ismajli

Ztr. Nebih Haziri

Kryeshef Ekzekutiv

Zyrtari Kryesor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
Pasqyra e të Hyrave Gjithëpërfshirëse për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Të hyrat operative		
Transmisioni i energjisë	14 14,706	20,076
Të hyrat tjera operative	15 3,543	2,348
	18,249	22,424
Minus: Shpenzimet operative		
Shpenzimet e Stafit	16 (2,945)	(2,736)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4-5 (6,349)	(4,866)
Riparimet dhe mirëmbajtja	17 (744)	(752)
Humbjet në transmision të energjisë	(3,579)	(4,319)
Shpenzimet tjera operative	18 (1,333)	(1,514)
Rregullimi sekondar	-	(1,600)
Provizioni për të arkëtueshmet	7 (2,390)	(2,765)
Provizioni për dëmtim të inventarit	(23)	(32)
Fitimi Operativ	886	3,840
Të hyrat e Interestit	543	301
Fitimi para tatimit	1,429	4,141
Shpenzimet e tatimit	19 (146)	(673)
FITIMI NETO PËR VITIN	1,283	3,468
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
TOTALI I TË HYRAVE GJITHPËRFSHIRËSE PËR VITIN	1,283	3,468

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Fitimet e mbajtura	TOTALI
	(in EUR 000)			
Bilanci më 1 Janar 2010	25	28,347	10,617	38,989
Neto fitimi për vitin	-	-	3,468	3,468
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2010	25	28,347	14,085	42,457
Bilanci më 1 Janar 2011	25	28,347	14,085	42,457
Neto fitimi për vitin	-	-	1,283	1,283
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2011	25	28,347	15,368	43,740

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
Pasqyra e të Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		1,429	4,141
Korrigjuar për:			
Zhvierësimin dhe amortizimin	4-5	6,349	4,866
Të hyrat nga interesi	15	(543)	(301)
Neto shlyerjet e aseteve fikse	4	2	8
Provizioni për dëmtim të inventarit	6	23	32
Provizioni për të arkëtueshmet	7	2,390	2,765
Të hyrat shtyra nga grantet	12	(3,276)	(1,828)
Shpenzimi i tatimit në fitim	19	194	657
Suficiti operativ para ndryshimeve në asete dhe obligime		6,568	10,340
(Rritja)/zvogëlimi në inventar		(560)	76
Rritja në të arkëtueshmet		(973)	(2,245)
Zvogëlimi në kërkesa tjera (Zvogëlimi)/rritja në të pagueshmet dhe obligime tjera		3,805	1,615
		(1,649)	748
Paraja e gjeneruar në operacione		7,191	10,534
Tatimi në fitim i paguar		(194)	(500)
Neto paraja e gjeneruar në operacione		6,997	10,034
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive			
Interesi i pranuar		543	301
Blerjet e aseteve fikse	4	(11,617)	(18,473)
Blerja e aseteve të paprekshme	5	(1,466)	(7)
Neto paraja e përdorur në aktivitetet investive		(12,540)	(18,179)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Grantet e pranuar		9,298	14,019
Grantet e kthyera (të papërdorura)		-	(161)
Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		9,298	13,858
Neto rritja e parasë dhe ekuivalenteve të parasë		3,755	5,713
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		14,850	9,137
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	9	18,605	14,850

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Indeksi i tabelave

Tab. 1 Gjatësia e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre	17
Tab. 2 Vjetërsia e linjave të rrjetit të KOSTT për vitin 2011	17
Tab. 3 Kapacitetet transformuese të rrjetit të KOSTT-it për vitin 2011	18
Tab. 4 Kapacitetet e interkonjeksionit për vitin 2011	18
Tab. 5 Balanca e realizuar 2010/2011	28
Tab. 6 Importi dhe eksporti 2010/2011	29
Tab. 7 Indikatorët e performances 2010/2011	31
Tab. 8 Transaksionet në tregun me shumicë	40

Indeksi i figurave

Fig. 1 Harta e Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës	12	Fig. 28 Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jotarifor për vitin 2010/2011	40
Fig. 2 Vjetësia e linjave e shprehur në përqindje	17	Fig. 29 Rrjedhat vjetore të energjisë në interkoneksione për vitin 2010/2011	41
Fig. 3 Numri i aseteve sipas nivelit të tensionit për vitin 2011	18	Fig. 30 Krahasimi i prodhimit, konsumit, importit dhe eksportit për vitet 2010-2011	41
Fig. 4 Krahasimi i aseteve të rrjetit të KOSTT për vitet 2010 dhe 2011	19	Fig. 31 Importi dhe eksporti në MWh sipas muajve të vitit 2010-2011	43
Fig. 5 Krahasimi i planifikimit me realizim për LP në vitin 2011	19	Fig. 32 Diagrami i çmimit mesatar të importit	44
Fig. 6 Krahasimi i planifikimit me realizim për NS në vitin 2011	20	Fig. 33 Tranziti i energjisë elektrike në rrjetin horizontal të Kosovës 2010/2011	45
Fig. 7 Krahasimi i intervenimeve në nënstacione për vitet 2007-2011	20		
Fig. 8 Krahasimi i intervenimeve në linja për vitet 2007-2011	20		
Fig. 9 Krahasimi i rënieve të LP-ve 2009-2011	21		
Fig. 10 Numri i prishjeve në Stabilimente të Tensionit të lartë(STL) në 100 fusha	22		
Fig. 11 Koha mesatare e riparimit të prishjes në linja gjatë viteve 2009-2011	22		
Fig. 12 Koha mesatare e riparimit të prishjes në fusha në nënstacione gjatë viteve 2009-2011	22		
Fig. 13 Rritja e kapacitetit të rrjetës së Transmisionit	20		
Fig. 14 Zhvillimi i kapacitetit sipas viteve	26		
Fig. 15 Përmirësimi i profilit të tensionit në nivelin e tensionit 110kV	26		
Fig. 16 Importi dhe shkëmbimet-marrje 2010, 2011	29		
Fig. 17 Eksporti dhe shkëmbimet- marrje 2010, 2011	30		
Fig. 18 Energjia e pafurnizuar 2007, 2008, 2009, 2010, 2011	32		
Fig. 19 Humbjet në transmision 2006-2011	32		
Fig. 20 Konsumi dhe piku 2006-2011	32		
Fig. 21 Piku javor 2009, 2010, 2011	33		
Fig. 22 Lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës 2009, 2010, 2011	33		
Fig. 23 Paraqitja në përqindje e rritjes së konsumit për vitin 2011 ndaj 2010 dhe 2010 ndaj 2009	34		
Fig. 24 Shtrirja gjeografike e Fibrit Optike në rrjeten Transmetuese në Kosovë	36		
Fig. 25 Arkitektura logjike e funksionimit të rrjetit telekomunikues	36		
Fig. 26 Principi i menaxhimit të rrjetit telekomunikues	37		
Fig. 27 Dizjani i sistemit SCADA/EMS	38		

Përgatitja e Raportit Vjetor 2010/2011 koordinuar nga:
Kadri Kadriu, zv. KSHE për Operim dhe Transmision të Sistemit
Visar Hoxha, u.d Sekretar i Komapnisë
Elvane Devexhi Osmani, Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun

Me kontributin e punonjësve të KOSTT:

Naim Bejtullahu, Nebih Haziri, Sabri Musiqi, Ilir Shala, Besim Gerxhaliu, Skender Gjonbalaj, Resmije Ahma, Jusuf Imeri, Ibrahim Gashi, Gazmend Kabashi, Shpresa Kursani, Zana Bajrami Rama, Bukurije Dauti, Gonxhe Haziri, Sahit Halimi, Sadudin Havolli, Rexhep Selimi, Nagip Syla, Musa Kadriu, Shaban Neziri, Nergize Rezniciq, Agim Kastrati, Sherif Dedaqi, Vjosa Rezniciq, Safete Orana, Azem Kastrati, Rexhep Gerguri, Labinot Gashi

Fotografitë KOSTT sh.a
Dizajni: ASHA sh.p.k.

Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregut- KOSTT sh.a
Rr. Iljaz Kodra pn
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 501 601 5
Fax: +381 (0) 38 500 201
Web: www.kostt.com

E shtypur në nëntor 2012
Publikimi nuk është për shitje

www.kostt.com

